



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 92

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 31 maj 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj 41/2024, datë 2.5.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar..... 10239
Dekret i Presidentit nr. 205, datë 30.5.2024	Për shpallje ligji..... 10249
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 29.5.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”..... 10249
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 29.5.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 320, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e task-forcës për koordinimin e procesit të trajtimit të tokave bujqësore në përdorim, në kushtet e nenit 12, të ligjit nr. 20/2020”..... 10252
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 321, datë 29.5.2024	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës me nr. 448, me emërtimin “Ish-batalion AT”, me vendndodhje në Bicaj, Kukës, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si dhe për një shtesë në vendimin nr. 1068, datë 29.12.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar..... 10252
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 29.5.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 10254
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 323, datë 29.5.2024	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 10265

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 324, datë 29.5.2024	Për miratimin e kalendarit të integruar të veprimtarive, në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të 80-Vjetorit të Çlirimit.....	10276
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 29.5.2024	Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale.....	10283
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 29.5.2024	Për autorizimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin të negociojnë drejtpërdrejt me subjektin ndërkombëtar <i>BOSTON CONSULTING GROUP</i> (BCG) për ofrimin e shërbimit të konsulencës, për identifikimin e mekanizmave eficientë për të nxitur më tej luftën kundër korrupsionit dhe mundësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) për këtë qëllim.....	10284
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 29.5.2024	Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore”	10284
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 15, datë 23.5.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	10289
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 16, datë 23.5.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	10303



LIGJ
Nr. 41/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 107/2014,
“PËR PLANIFIKIMIN DHE
ZHVILLIMIN E TERRITORIT”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, “Përkufizime”, bëhen disa shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 9 togfjalëshi “nenin 16” zëvendësohet me togfjalëshin “nenin 15”.

2. Pikat 15, 24, 28, 39/1 ndryshohen si më poshtë:

“15. “Kushte zhvillimore” janë kushtet e përcaktuara nga dokumenti i planifikimit në fuqi ose, në rastet e investimeve strategjike dhe rastet përjashtimore, të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës i planifikimit dhe zhvillimit me rregullore të veçantë.”.

“24. “Njësi” është njësi strukturore e territorit, pjesë e zonës, që përdoret për qëllime planifikimi për të cilën dokumentet e planifikimit të territorit përcaktojnë kushtet zhvillimore të zbatueshme në territorin që ajo kufizon. Kushtet zhvillimore më pas detajohen në nivel njësie strukturore sipas përcaktimeve të planeve të detajuara vendore dhe dokumenteve të zhvillimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.”.

“28. “Përdorim i tokës” është qëllimi për të cilin është parashikuar të përdoret toka dhe strukturat në të, sikurse parashikohet në dokumentet e planifikimit apo në lejet e zhvillimit për rastet e KKTU-së.”.

“39/1 “Sistemi elektronik i lejeve (sistemi *e-Leje*)” është baza e të dhënave shtetërore për të gjitha kërkesat dhe lejet, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit apo legjislacionit sektorial, dhe realizon ndërveprimin e të gjitha subjekteve të përfshira në proces, duke përfshirë aplikuesin, autoritetet përgjegjëse për dhënien e lejeve dhe institucionet publike, që kanë detyrimin ligjor të japin informacion ose pëlqim lidhur me kërkesën për leje apo të miratojnë autorizime/leje dytësore në funksion të lejeve të zhvillimit/ndërtimit.”.

3. Pas pikës 39/1 shtohen pikat 39/2 dhe 39/3 me këtë përmbajtje:

“39/2. “Sistemi elektronik *e-Planifikim*” është sistem elektronik në të cilin ndërveprojnë aktorët dhe bashkërendohet procesi i hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit të çdo niveli, duke ndjekur dispozitat ligjore dhe afatet kohore të paracaktuara nga legjislacioni në fuqi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

39/3. “Sistem territorial” është bashkësia e një serie përbërësish territoriale për qëllime planifikimi, të ndërruar dhe bashkëveprues me njëri-tjetrin, të cilët formojnë një tërësi.”.

4. Pikat 44 dhe 44/1 ndryshohen si më poshtë:

“44. “Zona” është një pjesë e sistemit territorial, me karakteristika ose përdorime të veçanta apo të njëjta, ekzistuese a të planifikuara të tokës e ndërtimeve në të, sipas rregulloreve të përdorimit të tokës. Zona mund të përmbajë disa kategori përdorimi toke, të cilat duhet të jenë pjesë të një sistemi territorial në përputhje me kategorizimin e përdorimit të tokës. Zona mund të përputhet ose jo me një apo më shumë njësi strukturore të territorit.

44/1 “Zonë e zhvillimit” ose nënjësia strukturore është territori në funksion të procesit të zhvillimit, pjesë e një njësie strukturore, sipas përcaktimeve të planit të detajuar vendor.”.

5. Pas pikës 45 shtohen pikat 46 dhe 47 me këtë përmbajtje:

“46. “Hapësirë detare” është territori ujor, i cili përbëhet nga ujërat e brendshme detare, deti territorial, zona fqinje (në vazhdim), zona ekskluzive ekonomike dhe shelfi kontinental, sipas dispozitave të Kodit Detar.

47. “Brez i bregdetar” sipas këtij ligji përfshin sipërfaqen e tokës, përtej rrës dhe plazhit, deri në 300 m në brendësi të tokës, e matur në vijë ajrore.”.



Neni 2

Në shkronjën “ll” të nenit 4, “Parimet”, pas fjalës “hartimit” shtohet togfjalëshi “dhe rishikimit”.

Neni 3

Në pikën 1 të nenit 4/1, “Hapësira publike”, bëhen këto shtesa:

1. Para fjalës “lulishtja” shtohet togfjalëshi “kënde lojërash për fëmijë”.
2. Pas togfjalëshit “Për pronat e paluajtshme të shtetit” shtohet fjala “i ndryshuar”.

Neni 4

Në nenin 6, “Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën “b” të pikës 1 para fjalës “planeve” shtohet emërtesa “Planit Kombëtar të Hapësirës Detare”.
2. Në fund të shkronjës “a” të pikës 2 shtohen fjalët “dhe Planit Kombëtar të Hapësirës Detare”.
3. Në pikën 3 fjalët “Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit, planet kombëtare sektoriale dhe planet e detajuara për zona me rëndësi kombëtare” zëvendësohen me fjalët “dokumentet e planifikimit kombëtar në fuqi”.

Neni 5

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

**Përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të
Territorit dhe Ujit (KKTU)
në fushën e planifikimit të territorit**

Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit vendos për:

- a) miratimin, miratimin me ndryshime ose shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm të dokumenteve të planifikimit, kërkuar për miratim nga autoritetet e planifikimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- b) miratimin e dokumenteve të planifikimit sektorial, të përcaktuara me legjislacion të posaçëm dhe që kanë efekte në territor;
- c) përcaktimin e rëndësisë kombëtare të një çështjeje, zone ose objekti në planifikimin e territorit

Faqe | 10240

dhe miratimin e planeve të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare kur parashikohen të tilla nga Planin i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit dhe dokumente të tjera planifikimi në fuqi;

ç) miratimin e planeve dhe projekteve ndërrajonale dhe kombëtare në fushën e furnizimit me ujë, bujqësisë, urbanistikës, zhvillimit industrial dhe të territorit kur ato lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve ujore, sipas legjislacionit të posaçëm për menaxhimin e burimeve ujore;

d) marrjen e masave të duhura për zbatimin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare për burimet ujore në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, sipas legjislacionit të posaçëm për menaxhimin e burimeve ujore;

dh) kufizime për përdorimin e zonave të përmbytura ose të zonave që janë nën efektin e dëmshëm të ujit;

e) përcaktimin dhe ndryshimin e regjimit të zonave të mbrojtura të shpallura në rastet e pashmangshme dhe kufijve të tyre;

ë) shpalljen e zonave vulnerabël në përputhje me parashikimet në legjislacionin për menaxhimin e burimeve ujore;

f) miratimin e vlerësimit paraprak të riskut nga përmbytjet;

g) miratimin e hartave të riskut nga përmbytjet dhe hartave të rrezikut nga përmbytjet;

gj) miratimin e akteve rregullatore të përkohshme për zona të caktuara apo në të gjithë territorin, rregullave dhe kriterëve për ndalimin apo lejimin e shfrytëzimit të burimeve ujore, shkarkimeve ose aktiviteteve të tjera të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në burimet ujore;

h) miratimin me vendime qarkulluese të akteve rregullatore lidhur me planifikimin dhe zhvillimin e territorit për të gjithë territorin.”.

Neni 6

Pas nenit 7 shtohen nenet 7/1 dhe 7/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

**Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të
Territorit dhe Ujit**

1. Agjencia e Zhvillimit të Territorit (Agjencia) është person juridik publik me vetëfinancim, në varësi të Kryeministrit, e cila ka përgjegjësi



zhvillimin e territorit dhe kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.

2. Burimet e financimit për Agjencinë janë:

- a) të ardhurat e krijuara nga vetë Agjencia;
- b) burime të tjera të ligjshme;
- c) buxheti i shtetit.

3. Buxheti i Agjencisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban.

4. Të ardhurat e krijuara nga Agjencia janë të trashëgueshme ndërmjet viteve buxhetore dhe përdoren për mbulimin e kostove e të shpenzimeve të veta.

5. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë, numrin e punonjësve, nivelet e pagave e të shpërblimit dhe marrëdhëniet e tyre të punës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban.

Neni 7/2

Përgjegjësitë e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit

Sekretariati Teknik i këtij Këshilli, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, e cila ka këto përgjegjësi:

- a) organizon mbledhjet e KKTU-së;
- b) përgatit dhe administron dokumentacionin që shqyrtohet nga KKTU-ja në fushën e planifikimit e zhvillimit të territorit, duke drejtuar dhe bashkërenduar procesin me autoritetet e tjera përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, sipas parimit të shërbimit me një ndalesë;
- c) ndërvepron me institucionet e tjera shtetërore, në emër dhe për llogari të aplikuesit, gjatë procedurës së shqyrtimit/miratimit/lëshimit të autorizimeve/lejeve dytësore, të cilat janë të domosdoshme, në funksion të miratimit të lejes së ndërtimit;
- ç) pranon njoftimin për fillimin e punimeve, si dhe kryen, rast pas rasti, pasi ta ketë vlerësuar në varësi të kompleksitetit që paraqet projekti i miratuar nga KKTU-ja, monitorimin e procesit të zbatimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të tyre;
- d) vë në zbatim vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit dhe monitoron zbatimin e tyre nga njësitë e qeverisjes vendore e institucionet e tjera përgjegjëse;

dh) kryen monitorimin e zhvillimeve në territor, si dhe përgatit raportin përkatës për të informuar Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Ujit e autoritetet e tjera që kanë përgjegjësi në fushën e zhvillimit të territorit;

e) administron dokumentacionin që shoqëron propozimet e paraqitura nga IKMT-ja, si dhe kryen përgatitjet për shqyrtimin e këtij dokumentacioni nga KKTU-ja gjatë zhvillimit të procedurave për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje me qëllim fitimi;

ë) kryen komunikimin me palë të treta për llogari të KKTU-së;

f) administron informacionin në sistemin elektronik të lejeve (*e-Leje*), duke pasur akses në këtë sistem, në drejtim të verifikimit të të dhënave parësore dhe dytësore që kjo bazë të dhënash grumbullon, si dhe të përmirësimit të procedurave që kryhen nëpërmjet sistemit;

g) kryen trajnime për subjektet fizike dhe juridike, publike dhe private, lidhur me përdorimin dhe procedurat që kryhen nëpërmjet sistemit *e-Leje*;

gj) komunikon, shpërndan dhe boton në sistemin elektronik të lejeve vendimet dhe dokumentet e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit;

h) ofron mbështetje ndaj njërive të qeverisjes vendore në proceset e tyre të zbatimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

i) përfaqëson Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Ujit në të gjitha çështjet, objekt shqyrtimi gjyqësor, që kanë lidhje me vendimet e miratuara dhe procedurat e kryera nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit.”.

Neni 7

Në nenin 8, “Përgjegjësitë e ministrisë së linjës për zhvillimin urban”, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja “c” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“c) marrjen e nismës dhe koordinimin e punës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe Planit Kombëtar të Hapësirës Detare, si dhe për rishikimin e tyre;”.

2. Në shkronjën “d” të pikës 1 pas emërtesës “Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”



shtohen fjalët “dhe Planit Kombëtar të Hapësirës Detare”.

3. Në pikën 2 pas emërtesës “Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit” shtohet emërtesa “Planit Kombëtar të Hapësirës Detare”.

Neni 8

Në nenin 9, “Përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “b” pas fjalës “hartimit” shtohen fjalët “dhe rishikimit të dokumenteve të planifikimit, si dhe”.

b) Në shkronjën “ç” pas fjalëve “për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit” shtohen fjalët “dhe pranë Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit”.

c) Shkronjat “dh” dhe “p” ndryshohen si më poshtë:

“dh) për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit me ligjet, dokumentet e planifikimit të niveleve më të larta sipas hierarkisë së tyre.”.

“f) për të informuar publikun për proceset e planifikimit të territorit;”.

ç) Pas shkronjës “p” shtohen shkronjat “g”, “gj” dhe “h” me këtë përmbajtje:

“g) për të inkurajuar dhe siguruar që pjesëmarrja e publikut është garantuar gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit;

gj) asiston në hartimin e dokumenteve të planifikimit në nivel kombëtar, si dhe mund të hartojë dokumente planifikimi me kërkesë të ministrive sipas fushës së tyre të përgjegjësisë dhe veprimtarisë në planifikimin e territorit;

h) udhëheq, koordinon dhe ndërlikohet veprimtaritë për modernizimin e modelit të planifikimit dhe promovimin e praktikave novatore në arkitekturë e planifikim.”.

2. Në fjalinë e parë të pikës 2 pas fjalës “hartimi” shtohen fjalët “dhe rishikimi”.

3. Në shkronjën “a” të pikës 2 pas fjalës “hartimit” shtohen fjalët “dhe rishikimit”.

Neni 9

Në shkronjën “dh” të pikës 1 të nenit 10, “Përgjegjësitë e ministrive të tjera”, pas emërtesës “Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit” shtohen fjalët “dhe sistemin e-Planifikimi”.

Neni 10

Shkronja “ç” e nenit 12, “Përgjegjësitë e Këshillit Bashkiak”, shfuqizohet.

Neni 11

Në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 13, “Përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë”, pas emërtesës “Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit” shtohen fjalët “dhe dokumente të tjera të planifikimit të territorit në fuqi”.

Neni 12

Në shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 14, “Kontributet profesionale në planifikim”, pas fjalëve “ose projektim urban” shtohen fjalët “ose arkitekt”.

Neni 13

Paragrafi 1.1 i pikës 1 të nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

“1.1. Planifikimi i nivelit qendror, që kryhet përmes dokumenteve të planifikimit, si vijon:

1.1.1. Plan i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

1.1.2. Planet kombëtare sektoriale për të gjithë ose një pjesë të territorit;

1.1.3. Plan Kombëtar i Hapësirës Detare për të gjithë hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë;

1.1.4. Planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare;

1.1.5. Planet e detajuara qendrore.”.

Neni 14

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje:



“Neni 16/1

Plani Kombëtar i Hapësirës Detare

1. Plani Kombëtar i Hapësirës Detare synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorëve të energjisë në det, transportit detar, peshkimit dhe akuakulturës, turizmit, ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, duke përfshirë qëndrueshmërinë ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike, promovimin e nxjerrjes së qëndrueshme të lëndëve të para, promovimin dhe sigurimin e aktiviteteve dhe përdorimeve përkatëse detare, si dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar.

2. Planifikimi i hapësirës detare zhvillohet dhe zbatohet duke marrë parasysh:

a) veçoritë e hapësirave detare, aktivitetet dhe përdorimet përkatëse aktuale dhe të ardhshme të tyre, efektet e lidhura me mjedisin, si dhe burimet natyrore;

b) aspektet ekonomike, sociale dhe mjedisore, si dhe aspektet që lidhen me sigurinë e përdorimeve civile e prodhuese të detit;

c) ndërveprimet tokë-det, duke përfshirë përdorimin e elementeve të përfshira në procese të tjera planifikimi, të tilla si: menaxhimi i integruar i zonës bregdetare, plane sektoriale apo plane vendore që kanë lidhje me hapësirat detare.

3. Plani Kombëtar i Hapësirës Detare hartohet nga ministria përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin si autoritet kompetent në bashkëpunim me ministrinë e tjera, për sa kanë fushën e tyre të përgjegjësisë dhe veprimtarisë.”

Neni 15

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Planet kombëtare sektoriale

1. Planet kombëtare sektoriale hartohen me qëllim zhvillimin strategjik të një ose më shumë sektorëve të ndryshëm, sipas fushave të kompetencës, si: siguria kombëtare, energjia, industria, transporti, infrastruktura, turizmi, zonat ekonomike, arsimi, sporti, trashëgimia kulturore apo/dhe natyrore, burimet natyrore, shëndetësia, bujqësia, ujërat, si dhe mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore.

2. Autoriteti përgjegjës për ndërmarrjen e nismës dhe hartimin e planeve kombëtare sektoriale është ministria që mbulon sektorin për të cilin hartohet plani dhe miratohet nga KKTU-ja.

3. Në rastet kur dy a më shumë ministri bashkëpunojnë për planifikimin e dy a më shumë sektorëve njëkohësisht, dokumenti i planifikimit klasifikohet si ndërsektorial. Autoriteti përgjegjës për ndërmarrjen e nismës për hartimin e këtij dokumenti është ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

4. Struktura dhe forma, procedura e hartimit dhe miratimit të planeve sektoriale përcaktohen në rregulloren e planifikimit të territorit. Planet kombëtare ndërsektoriale kanë strukturë dhe procedurë të hartimit/miratimit të tyre të njëjtë me planet kombëtare sektoriale.”

Neni 16

Në nenin 18, “Planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Dokumenti i nismës hartohet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për zonën e rëndësishme kombëtare ose palët e interesuara.

3. Plani i detajuar për zonën e rëndësishme kombëtare hartohet nga ministri përgjegjës për çështjen e rëndësishme kombëtare, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit ose nga palët e interesuara, nën mbikëqyrjen e autoritetit publik përgjegjës për zonën/çështjen e rëndësishme kombëtare, sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren e planifikimit të territorit dhe miratohet nga KKTU-ja.”

2. Në pikën 5 fjalët “rregulloren e zhvillimit” zëvendësohen me fjalët “rregulloren e planifikimit”.

Neni 17

Pas nenit 18 shtohet neni 18/1, “Planet e detajuara qendrore”, me këtë përmbajtje:

“Neni 18/1

Planet e detajuara qendrore

1. Planet e detajuara qendrore hartohen nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në



bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjen/sectorin përkatës apo institucione të tjera qendrore dhe, sipas rastit, me subjekte private të përzgjedhura nëpërmjet një procedure konkurrimi publik ose nëpërmjet një mbështetjeje tjetër financiare.

2. Plani i detajuar qendror ka për qëllim krijimin e bazave për zhvillimin e kontrolluar të territorit për të cilin hartohet, si krijimin e bazave për zhvillimin e vendbanimeve, infrastrukturës, turizmit, industrisë etj.

3. Plani hartohet për një temë/çështje të caktuar, që përfshin pjesë të veçanta të territorit kombëtar dhe miratohet nga KK-TU-ja.

4. Rregullat dhe procedura për hartimin e planit të detajuar qendror do të përcaktohen në rregulloren e planifikimit.”

Neni 18

Në nenin 20, “Plani i përgjithshëm vendor”, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “c” të pikës 1 fjalët “sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme” zëvendësohen me fjalën “territorit”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale në nivel bashkiak, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit/ndërtimit.”

Neni 19

Në nenin 22, “Plani i detajuar vendor”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti i planifikimit dhe zhvillimit vendor përcakton në Planin e Përgjithshëm Vendor territoret, të cilat do t’i nënshtrohen hartimit të planeve të detajuara vendore, mbi bazën e kritereve të përcaktuara në rregulloren e planifikimit.”

2. Në pikën 2 termi “zona” zëvendësohet me “territore”.

3. Në shkronjën “a” të pikës 3 termi “zona” zëvendësohet me fjalët “njësi apo/dhe disa njësi strukturore”.

4. Në shkronjën “b” të pikës 3 fjalët “kryesisht urbane” shfuqizohen.

5. Në pikën 4 pas fjalës “bashkimin” shtohen fjalët “e parcelave”.

6. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. I gjithë procesi i nisjes, konsultimit, bashkërendimit dhe miratimit të dokumenteve të planeve të detajuara vendore nga autoritetet vendore do të realizohet nëpërmjet sistemit elektronik *e-Planifikimi*.”

7. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Kryetari i bashkisë vendos miratimin e planit të detajuar vendor bazuar në raportin teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor dhe pas lëshimit të aktit të përputhshmërisë nga AKPT-ja. Në rastet e hartimit të PDV-së me nismë private, kryetari vendos miratimin e planit të detajuar vetëm në rast se nuk shprehen kundër banorët që kanë në pronësi më shumë se një të tretën e sipërfaqes së zonës përkatëse të zhvillimit.”

8. Në pikën 13 pas fjalës “zonës” shtohen fjalët “njësisë strukturore”.

9. Pika 14 shfuqizohet.

10. Në pikën 15 fjalët “kryesisht në zonën ku janë përfituar” shfuqizohen.

Neni 20

Pika 1 e nenit 23, “Bashkërendimi”, ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti përgjegjës për hartimin/rishikimin e dokumentit të planifikimit siguron një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi horizontal e vertikal me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara, përpara fillimit dhe gjatë hartimit/rishikimit të dokumenteve të planifikimit.”

Neni 21

Në nenin 24, “Këshillimi dhe takimi publik”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 pas fjalës “hartimit” shtohet fjala “/rishikimit”.

2. Në pikën 7 pas fjalës “hartimit” shtohet fjala “/rishikimit”, si dhe shfuqizohet fjala “kombëtar”.

Neni 22

Në nenin 25, “Miratimi i dokumenteve të planifikimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:



1. Në shkronjën “b” të pikës 1 para lidhëzës “ose” shtohet lidhëza “dhe”.

2. Në pikën 4 pas emërtesës “Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit” shtohen fjalët “edhe në sistemin *e-Planifikimi*”.

3. Pika 4/1 ndryshohet si më poshtë:

“4/1. Autoriteti përgjegjës për miratimin përfundimtar, jo më vonë se 15 ditë pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit dhe sistemin *e-Planifikimi*, dërgon pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për regjistrim planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare dhe planet e detajuara vendore. Me regjistrimin e vendimit të lejes së zhvillimit ose vendimit të lejes së ndërtimit, sipas rastit, me kërkesë të zhvilluesit apo autoritetit përgjegjës për miratimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit, ndryshon automatikisht resursi i tokës, sipas parashikimit të planit.”.

Neni 23

Në nenin 26, “Rishikimi i planeve”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Dokumentet e planifikimit korrigjohen në rastet kur konstatohen: gabime drejtshkrimore; dy ose më shumë parashikime të ndryshme për të njëjtën zonë/njësi strukturore në dokumente të ndryshme përbërëse të planit; mospërputhje të treguesit të lartësisë në kate me atë të lartësisë në metra; mospërputhje të përcaktimeve në dokumentin e planifikimit me gjendjen faktike të zhvillimeve në territor.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ndryshimi i planeve ndiqet nga autoriteti publik përgjegjës për planifikimin e territorit duke caktuar grupe pune ose, sipas rastit, duke kontraktuar ekspertë teknikë të jashtëm, përfituar nga një procedurë konkurrimi publik apo nëpërmjet një mbështetjeje tjetër financiare.

Për ndryshimin e planeve, autoriteti publik nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit mund të zhvillojë edhe konkurse publike planifikimi/projektimi, me qëllim përzgjedhjen e ideve më të mira për planifikimin dhe zhvillimin e një zone.

Rregullat dhe procedura e ndryshimit të dokumenteve të planifikimit apo rishqyrtimit të

plotë të tyre, sipas këtij neni, do të përcaktohen në rregulloren e planifikimit.”.

Neni 24

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU) në fushën e zhvillimit të territorit

1. KKTU-ja është autoriteti përgjegjës vendimmarrës për:

a) leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për të gjitha llojet e zhvillimeve komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit të territorit;

b) leje zhvillimi dhe ndërtimi për objektet brenda brezit bregdetar, sipas legjislacionit në fuqi;

c) çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare, si dhe investime strategjike për interesat e vendit;

ç) miratimin e vendimeve për konfiskimin apo ndryshimin e lejeve të ndërtimit, për objektet pa leje apo në tejkalim të lejes së ndërtimit, të cilat kalojnë në favor të shtetit, me qëllim përdorimin e tyre për nevoja të strehimit social apo për interes publik;

d) miratimin e lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e burimeve ujore dhe për shkarkimet, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm, si dhe në rastet kur këto akte i paraprijnë miratimit të një lejeje ndërtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit;

dh) dhënien e autorizimit për ndërtimin e strukturave ankoruese dhe portuale, veprave të mbrojtjes bregdetare dhe ishujve artificialë në det;

e) dhënien e miratimit në parim për përdorimin e burimeve ujore, me kërkesë të çdo autoriteti kontraktor përpara se të nisë një procedurë koncesioni;

2. Lëshimi i certifikatës së përdorimit për lejet e ndërtimit, të miratuara sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet në përfundim të një procesi të bashkërenduar të kontrollit të përputhshmërisë së ndërtimit mes autoriteteve qendrore të përfshira, sipas fushës së kompetencës, dhe autoritetit vendor përgjegjës për kontrollin e punimeve të ndërtimit në territorin administrativ ku kryhet zhvillimi.

3. KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në



kompetencë të saj. Format i TIP i kësaj rregulloreje detajohet në rregulloren e zhvillimit të territorit.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin ajror, miraton rregullat për zhvillimin e zonave aeroportuale.”

Neni 25

Në nenin 31, “Transferimi i së drejtës për zhvillim”, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1.1. Transferimi i së drejtës për zhvillim mund të jetë i vullnetshëm apo i detyruar. Në rastin e detyrimit të transferimit të së drejtës për zhvillim, ky detyrim bëhet me qëllimin e ruajtjes së monumenteve të kulturës, zonave historike dhe hapësirave publike.”

2. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Transferimi i së drejtës për zhvillim në mënyrë të vullnetshme nuk ka nevojë për hartimin e programit.”

Neni 26

Neni 37, “Kushtet për zhvillim”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 37

Kushtet për zhvillim

1. Zhvillimi lejohet vetëm në kushtet e përcaktuara nga dokumentet e planifikimit apo në rregulloret e veçanta të miratuara nga KKTU-ja, për rastet në kompetencë të tij.

2. Për investimet strategjike, të miratuara si të tilla me vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike, si dhe për zhvillimet prioritare sipas politikave të ministrive të linjës, përdorimi i tokës dhe kushtet e zhvillimit, pavarësisht nga parashikimet në dokumentet e planifikimit, përcaktohen në rregullore të veçantë, të miratuara nga KKTU-ja.”

Neni 27

Në pikën 2 të nenit 38, “Leja e zhvillimit”, pas fjalës “parcelë” shtohen fjalët “ose grup parcelash”.

Neni 28

Në pikën 1 të nenit 39, “Leja e ndërtimit”, fjala “riparim” shfuqizohet.

Neni 29

Pika 6 e nenit 40, “Afati i lejes së ndërtimit”, ndryshohet si më poshtë:

“6. Për punimet e filluara prej më shumë se dhjetë vjetësh dhe ende të papërfunduara, sipas projektit të miratuar, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit miraton procedurën për mënyrën e përfundimit të punimeve, prishjen apo konfiskimin e ndërtimit.”

Neni 30

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

1. Kërkesa për leje ndërtimi kryhet ekskluzivisht nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit (*e-Leje*), me përjashtim të zhvillimeve, projekti i të cilave përmban informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, sipas legjislacionit të posaçëm.

2. Kërkesa për leje ndërtimi përmban një përshkrim të hollësishëm të punimeve që do të kryhen dhe shoqërohet nga dokumentacioni i plotë ndërtimor, përfshirë projektet e detajuara, të hartuara dhe të nënshkruara nën përgjegjësinë e ekspertëve të licencuar.

3. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit.

4. Rregullorja e zhvillimit të territorit detajon:

a) përmbajtjen e formularit të kërkesës për leje;
b) listën e plotë të dokumentacionit tekniko-ligjor që duhet të shoqërojë kërkesën;

c) procedurën që duhet të ndiqet nga zhvilluesit dhe autoritetet përkatëse, si në rastet kur shqyrtimi i kërkesës kryhet nëpërmjet sistemit *e-Leje*, ashtu edhe në rastin përjashtimor kur kryhet jashtë sistemit *e-Leje* sipas pikës 1 të këtij neni.

5. Autoriteti përgjegjës i zhvillimit nuk mund të përcaktojë procedura apo kërkesa të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë ligj dhe në rregulloren e zhvillimit për pajisjen me leje në fushën e ndërtimit.”



Neni 31

Neni 44, “Shqyrtimi i kërkesës për leje ndërtimi”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 44

Shqyrtimi i kërkesës për leje ndërtimi

1. Autoriteti përgjegjës, sipas nenit 27 të këtij ligji, shqyrton aplikimin për leje ndërtimi sipas parimit me një ndalesë, duke bashkërenduar punën me të gjitha autoritetet publike të specializuara që duhet të shprehen në lidhje me aplikimin.

2. Autoriteti përgjegjës vendos për lejen e ndërtimit brenda 60 ditëve pune nga dorëzimi i aplikimit për leje ndërtimi. Rregullorja e zhvillimit mund të përcaktojë afate më të shkurtra apo procedura të diferencuara për pajisjen me leje ndërtimi, për punime me impakt të ulët në territor apo për investime strategjike për vendin.

3. Në rast se gjatë koordinimit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës apo drejtoritë vendore të saj, këto të fundit nuk mund të ofrojnë informacionin e kërkuar brenda afateve të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit dhe kjo pengon autoritetin përgjegjës për marrjen e vendimit brenda afatit sipas pikës 2 të këtij neni, ASHK-ja apo drejtoritë vendore, sipas rastit, informojnë autoritetin përgjegjës për problematikat dhe afati për dhënien e informacionit zgjatet me 15 ditë. Zgjatja e këtij afati nuk duhet të kalojë afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni në të cilin autoriteti përgjegjës duhet të vendosë për lejen e ndërtimit.

4. Në rast se autoriteti përgjegjës nuk merr vendim brenda afatit të mësipërm dhe struktura përgjegjëse e planifikimit pranë autoritetit vendor nuk ka dhënë mendim negativ lidhur me kërkesën, leja e ndërtimit konsiderohet e dhënë në heshtje.

5. Miratimi në heshtje nuk zbatohet për lejet e ndërtimit që janë në kompetencë të KKTU-së, si dhe për punime të tjera, përfshirë ato me rrezikshmëri të lartë, që përcaktohen nga rregullorja e zhvillimit apo rregullohen në mënyrë të veçantë nga legjislacioni në fuqi.

6. Në rast refuzimi të kërkesës për leje ndërtimi ose kundërshtimi të deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve, vendimi duhet të jetë i arsyetuar.

7. Titullari i ASHK-së apo drejtorisë vendore, e cila nuk ka dhënë informacionin e kërkuar edhe pas

zgjatjes së afatit sipas pikës 3 të këtij neni, dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë lekë).”.

Neni 32

Pas nenit 46, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, shtohet neni 46/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 46/1

Tarifa e shërbimit

1. Autoriteti përgjegjës për zhvillimin e territorit, me qëllim mbulimin e shpenzimeve, zbaton tarifa për shërbimet që ofrohen dhe kryhen sipas këtij ligji, në kuadër të procesit të zhvillimit të territorit.

2. Tarifat për çdo shërbim, si dhe mënyra e përdorimit të tyre për kërkesat që janë kompetencë e KKTU-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa për kërkesat në kompetencë të njërive të qeverisjes vendore përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak.

3. Tarifa e shërbimit paguhet nga zhvilluesi për llogari të sekretariatit që kryen shërbimin përkatës, pasi t'i jetë vënë në dispozicion subjektit të interesuar fatura e arkëtimit për këtë shërbim.”.

Neni 33

Neni 49, “Stimuj zhvillimi”, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 49

Stimuj zhvillimi

1. Në varësi të llojit dhe volumit të investimeve, prioriteteve të zhvillimit vendor apo kombëtar apo zbatimit të lejeve të mëparshme të ndërtimit në mënyrën dhe afatet e caktuara, autoritetet e zhvillimit të territorit mund të parashikojnë procedura të përsheptuara apo incentiva zhvillimi për investitorë apo kërkesa të caktuara.

2. Në rastet, objekt shqyrtimi, pranë KKTU-së, procedura e përsheptuar mund të aplikohet sipas rregullave të detajuara në rregulloren e zhvillimit të territorit, për:

a) investime strategjike;

b) zhvillime komplekse brenda brezit bregdetar.”.



Neni 34

Në nenin 52, “Kundërvajtjet administrative”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, përveç rasteve kur përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:”.

2. Paragrafi “iv” i shkronjës “e” të pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“iv. konfiskim për interes publik, me propozim të IKMT-së ose IMT-së dhe vendim të KKTU-së, për të gjithë objektin, kur ndërtesa është e qëndrueshme, në rastet kur:

- ndërtimi rezulton pa leje, në masën 100% të sipërfaqes ndërtimore mbi tokë;

- ndërtimi pa leje rezulton si shtesë kati dhe si shtesë volumni anësor, nëse tejkalon masën 10% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi tokë;

Rregullat dhe procedurat përkatëse për konfiskimin për interes publik miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

3. Pas shkronjës “h” të pikës 1 shtohet shkronja “i” me këtë përmbajtje:

“i) miratimi i dokumentit të Planit të Detajuar Vendor në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor apo dokumente të tjera të planifikimit në fuqi dënohet me gjobë nga 3 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë;”.

4. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Për shkeljet që përbëjnë vepër penale, autoritetet e inspektimit bëjnë menjëherë kallëzim për ndjekje penale.”.

Neni 35

Titulli i nenit 54 ndryshohet në “Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit dhe sistemi *e-Planifikimi*”.

Neni 36

Në nenin 55, “Organizimi dhe funksionimi i regjistrit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i nenit 55 ndryshohet në “Organizimi dhe funksionimi i Regjistrit dhe sistemi *e-Planifikimi*”.

2. Në fund të pikës 1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit (*e-Planifikimi*) është i organizuar me tre komponentë:

a) sistemi elektronik *e-Planifikimi*, i cili përfaqësohet nga mjedisi i punës, ku procesi i hartimit të dokumenteve të planifikimit ndjek hapat e përcaktuar sipas rregullores së regjistrit.

b) harta GIS ku shfaqen/ruhen të gjitha materialet *shapefile*, që u përkasin fazave të ndryshme të hartimit të dokumenteve të planifikimit.

c) arkiva, ku depozitohen të gjitha dokumentet e planifikimit, të cilat janë finalizuar me miratimin e tyre.

Të dhënat parësore, dytësore, ndërveprimi dhe subjektet e interesuara për Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (*e-Planifikimi*) përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 37

Në nenin 57, “Rregullat për regjistrin”, shkronja “b” shfuqizohet.

Neni 38

Kudo në tekstin e ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” bëhen këto zëvendësime:

1. Emërtimi “Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT)” zëvendësohet me “Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit (KKTU)”.

2. Termat “aplikim” dhe “aplikant” zëvendësohen me termat “kërkesë” dhe “kërkues”.

Neni 39

Dispozitë kalimtare

Përrjashtimisht për periudhën deri më 31 dhjetor 2024, kostot dhe shpenzimet e Agjencisë do të mbulohen nga buxheti i shtetit, ndërsa çdo e ardhur e krijuar nga vetë Agjencia deri në këtë datë trashëgohet për t’u përdorur prej saj pas kësaj date.

Neni 40

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.5.2024.

Shpallur me dekretin nr. 205, datë 30.5.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

**DEKRET****Nr. 205, datë 30.5.2024****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 41/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 319, datë 29.5.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 782, DATË 7.10.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
MODELEVE TË AKTEVE KADASTRALE
DHE TË DHËNAVE NË PËRMBAJTJE TË
HARTËS KADASTRALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 5, 15, pika 3, e 17, pika 7, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e dytë, e pikës 24, të kreut V, “Akte të tjera kadastrale” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Këto vërtetime provojnë se pronari ka depozituar dokumentet ligjore për regjistrim, por prona ndodhet në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar ende regjistrimit fillestar. Ky vërtetim është i vlefshëm për përdorim nga pronari dhe autoritetet publike deri në përfundimin e procesit të regjistrimit fillestar. ASHK-ja garanton statusin juridik të pasurisë së paluajtshme vetëm pas përfundimit të regjistrimit fillestar sistematik të zonës kadastrale ku ndodhet pasuria.”.

2. Anekset 7 dhe 8, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me anekset me të njëjtin numërtim dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



Aneks 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

VËRTETIM

Ky vërtetim lëshohet bazuar në nenin 19, pika 2, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, për të provuar se pronari ka depozituar dokumentet ligjore për regjistrim, por prona ndodhet në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar ende regjistrimit fillestar. Ky vërtetim është i vlefshëm për përdorim nga pronari dhe autoritetet publike deri në përfundimin e procesit të regjistrimit fillestar. ASHK-ja garanton statusin juridik të pasurisë së paluajtshme vetëm pas përfundimit të regjistrimit fillestar sistematik të zonës kadastrale ku ndodhet pasuria.

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri (emër, atësi dhe mbiemër)/emri i personit juridik	Numër personal ID-je/NIPT-i	Pjesa (-/-)

Nr. jopërfundimtar i pasurisë				
Zona kadastrale				
Lloji i pasurisë				
Sipërfaqja e pasurisë	Total:	Truall:	Ndërtesë:	
Kufitarët (nëse ka)	Në veri:	Në lindje:	Në jug:	Në perëndim:
Vlera aktuale e pasurisë				
Adresa e pasurisë				
Komente				

DREJTORI:

(emër, mbiemër)

Data e lëshimit ____/____/____

Nr. serialit _____



Shënim. Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistemin elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës).



Aneks 8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

VËRTETIM

Ky vërtetim lëshohet bazuar në nenin 19, pika 2, të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, për të provuar se subjekti është përfitues i të drejtës reale, por prona ndodhet në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar ende regjistrimit fillestar. Ky vërtetim është i vlefshëm për përdorim nga pronari dhe autoritetet publike deri në përfundimin e procesit të regjistrimit fillestar. ASHK-ja garanton statusin juridik të pasurisë së paluajtshme vetëm pas përfundimit të regjistrimit fillestar sistematik të zonës kadastrale ku ndodhet pasuria.

PËRFITUESI I SË DREJTËS (qiramarrës, enftëozëmarrës, kreditor, hipotekor etj.)	
Emri (emër, atësi dhe mbiemër)/emri i personit juridik	Numër personal ID-je/NIPT-i

Nr. jopërfundimtar i pasurisë				
Zona kadastrale				
Lloji i pasurisë				
Sipërfaqja e pasurisë				
Kufitarët (nëse ka)	Në veri:	Në lindje:	Në jug:	Në perëndim:
Afati i të drejtës				
Adresa e pasurisë				
Pronari/bashkëpronarët (qiradbënës, enftëozëdbënës etj)	Emri (emër, atësi dhe mbiemër)/emri i personit juridik	Numër personal ID-je/NIPT-i	Pjesa (_/_)	

DREJTORI: (emër, mbiemër)	Data e lëshimit ____/____/____ Nr. serialit _____
	Shënim. Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistemin elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës).



VENDIM
Nr. 320, datë 29.5.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 320, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË TRAJTIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE NË PËRDORIM, NË KUSHTET E NENIT 12, TË LIGJIT NR. 20/2020”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 11, të vendimit nr. 320, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, togfjalëshi “... 1 (një) viti...” zëvendësohet me “... 2 (dy) viteve...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 321, datë 29.5.2024

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË PRONËS ME NR. 448, ME EMËRTIMIN “ISH-BATALION AT”, ME VENDNDODHJE NË BICAJ, KUKËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, SI DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1068, DATË 29.12.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për

Faqe | 10252

pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës me nr. 448, me emërtimin “Ish-Batalion AT”, me vendndodhje në Bicaj, Kukës, sipas planrilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për nevoja të Institucionit të Paraburgimit Kukës.

2. Prona me nr. 448 hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1068, datë 29.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të IEVP Burgu nr. 325, Burgu Vaqar, Burgu nr. 302, Spitali i Burgut Tiranë, IEVP Shënkoll, Lezhë, IEVP Bënçë, Tepelenë, IEVP Rrogozhinë, IEVP Lushnjë (fshati Kosovë, Komuna Fierzë, Elbasan) dhe të godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”, të ndryshuar.


4. Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin atë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																	
Prona nr.448 " Ish Batalioni AT" Bicaj, Kukës																																	
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM, (FT)		DATË 03/05/2024 QËLLIMI Transferim nga MM te MD																															
VENDNDODHJA																																	
Bashkia Kukës	ZVASHK Kukës	Nr.Pasurisë 727/3	Z.K 2839 Indeksi i Hartës KU-OSMANAJ-54																														
TE DHËNAT E PASURISË																																	
Lloi i pasurisë	Sip e pasurisë 29461.92m² Sip e gjurmës së ndërtimit 2309m² Nr. kateve 1 Nr. pemeve																																
Nord = 4651158.80 East = 533385.93	KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)		Nord = 4651158.80 East = 533825.84																														
																																	
Shpjeguese: Sip. e përgj. e pronës = 29461.92m ² Sip. e përgj. e gjurmës së ndërtimit = 2309m ² Kufiri i pronës 																																	
Nord = 4650807.73 East = 533385.93	SH 1: 2500 METRA		Nord = 4650807.73 East = 533825.84																														
<table border="1"><thead><tr><th>NR</th><th>ORIENTIMI</th><th>PERDORIMI</th><th>TIPI I KUFIRIT</th><th>KUFITARI</th><th>ID NIPT</th></tr></thead><tbody><tr><td>1</td><td>Veri</td><td></td><td></td><td></td><td>K51726024H</td></tr><tr><td>2</td><td>Lundje</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>3</td><td>Jug</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>4</td><td>Perëndim</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></tbody></table>				NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID NIPT	1	Veri				K51726024H	2	Lundje					3	Jug					4	Perëndim				
NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID NIPT																												
1	Veri				K51726024H																												
2	Lundje																																
3	Jug																																
4	Perëndim																																
REALIZOI PËR IGJIU Ing. Eris Ndrukaj KONFIRMOI PËR IGJIU DREJTORI March. Teuta KANXHERI		TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto. PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas dokumentacionit hartografik arkivor, HTR. Shënim: Ky plan rilevimi u rihartua në zbatim të shkresës të Komandës FT nr.2447/1, datë 02.05.2024. Bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU-s, HTR-së dhe kartelës të pasurisë të paluajtshme b/lidhur shkresës, ortofoto e vitit 2015-2016. PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Forca Tokësore) MIRATOHET KOMANDANTI I FORCËS TOKËSORE Gjeneral Major XHEBEXHIA																															
REALIZOI PËR ASHK Specialisti DVASHK Nënshkrimi KONFIRMOI Përgjegjësi/Drejtori Nënshkrimi/ Vula																																	



VENDIM

Nr. 322, datë 29.5.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 153, DATË 7.4.2000,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
ZBATIMIN E KODIT RRUGOR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 232 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Ndryshimi i karakteristikave konstruktive të mjeteve në qarkullim dhe azhurnimi i lejes së qarkullimit (neni 77 i Kodit Rrugor)”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Pala e interesuar merr miratimin përpara ndryshimit konstruktiv në DPSHTRR. DPSHTRR-ja, bazuar në rregulloren e saj, jep miratimin ose refuzimin e ndryshimit konstruktiv të kërkuar. Afati i vlefshmërisë së licencës është 1 (një) vit. Në rinovimin e dytë dhe më tej ky afat është 5 (pesë) vjet.”.

Neni 2

Në nenin 237 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe zëvendësohet me: “Kushtet që duhet të plotësojnë mjetet që hyjnë në Republikën e Shqipërisë për t’u regjistruar dhe pajisur me lejeqarkullimi, certifikatë të përshtatshmërisë teknike dhe dokument identifikimi (nenet 92, 93 dhe 96 të Kodit Rrugor)”.

2. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

a) shkronja “a”, e ndarjes “A”, shfuqizohet.

b) në fund të ndarjeve “A”, shkronja “c”, dhe “B”, shkronja “b”, fjalët “... ose agjencia e shitjes, e ngarkuar prej tij ...” shfuqizohen.

3. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Karrelat dhe rimorkiot me masë maksimale të autorizuar deri në 750 kg pajisen nga organet e regjistrimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor me dokument identifikimi. Dokumenti i identifikimit përmban të dhënat e përcaktuara në rregulloren e DPSHTRR-së.

Targa përsëritëse lëshohet për çdo automjet me kërkesë të palës së interesuar. Përdorimi i tyre bëhet sipas rregullores së DPSHTRR-së.”.

4. Pika 3, shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 240 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Shenja e identifikimit të ciklomotorit është me sfond të bardhë dhe përmban sipas radhës karakterin alfabetik “C”, dy karaktere alfabetike, dhe tri karaktere numerike.

2. Forma dhe përmasat e shenjës së identifikimit të ciklomotorëve janë treguar në figurën III.3/1, të neni 246, të këtij vendimi.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 4

Neni 242 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 242

Detyrime për mbajtësin e shenjës së identifikimit për ciklomotorë dhe certifikatës së përshtatshmërisë teknike
(Neni 96 i Kodit Rrugor)

1. Në rast humbjeje, vjedhjeje ose shkatërrimi të shenjës së identifikimit (targës) së ciklomotorit, zotëruesi i saj duhet të denoncojë brenda 24 orëve në organet e policisë, të cilët lëshojnë vërtetimin për këtë denoncim. Me kërkesë të personit, ai mund të pajiset me shenjë identifikimi tjetër.

Kur shenja e identifikimit është e dëmtuar, lëshimi i shenjës së re bëhet me dorëzimin e asaj të dëmtuar.



2. Në rast humbjeje, vjedhjeje ose shkatërrimi të certifikatës së përshtatshmërisë teknike, zotëruesi i saj duhet të denoncojë brenda 24 orëve në organet e policisë, të cilët lëshojnë vërtetimin për këtë denoncim. Me kërkesë të personit, ai pajiset me certifikatë përshtatshmërie të re.

Kur certifikata e përshtatshmërisë teknike është e dëmtuar, lëshimi i certifikatës së re bëhet me dorëzimin e asaj të dëmtuar.”.

Neni 5

Në nenin 242/a bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor përcakton me rregullore sasinë e targave provë që mund t'i jepen subjektit. Gjithashtu, DPSHTRR-ja përcakton modelet e autorizimit për qarkullimin provë dhe librin e lëvizjes me targë provë.”.

2. Pikat 7 dhe 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“7. Autorizimi rinovohet me kërkesë të subjektit.

Në rast humbjeje, vjedhjeje ose shkatërrimi të autorizimit apo librit të lëvizjes (të vlefshëm), përfaqësuesi i subjektit duhet të denoncojë brenda 24 orëve në organet e policisë, të cilët lëshojnë vërtetimin për këtë denoncim. Me kërkesë të subjektit, ai pajiset me autorizim apo libër lëvizjeje (dublikatë ose të ri).

Në rast humbjeje, vjedhjeje ose shkatërrimi të targës provë, përfaqësuesi i subjektit duhet të denoncojë brenda 24 orëve në organet e policisë të cilët lëshojnë vërtetimin për këtë denoncim. Me kërkesë të subjektit, ai pajiset me targë provë tjetër.

Kur targa është e dëmtuar, lëshimi i targës së re bëhet me dorëzimin e asaj të dëmtuar.

8. Kur organi, që konstaton shkeljen për herë të tretë, siç parashikohet në pikën 3, të nenit 97, të Kodit Rrugor, autorizimin, librin e lëvizjes dhe targën provë i dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila shfuqizon autorizimin.”.

Neni 6

Pika 1, e nenit 243, shfuqizohet.

Neni 7

Shkronja “a”, e pikës 2, të nenit 244, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) ato që përmbajnë të dhënat e regjistrimit të mjeteve tërheqëse, me të cilat duhet të pajisen nga mbrapa karrelat dhe rimorkiot deri në 750 kg, gjatë qarkullimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 99, të Kodit Rrugor.”.

Neni 8

Në pikën 1, të nenit 246, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën “c” bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i tretë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“formati 305 x 153 mm, figura III.4/3.”.

b) Paragrafi i katërt ndryshohet, si më poshtë vijon:

“formati 360 x 100 mm, figura III.4/4.”.

c) Fjalja e dytë, e paragrafit të pestë, hiqet.

2. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Targat e regjistrimit për mjetet rrugore të veçanta përcaktohen në marrëveshje midis ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrave përkatës”.

Neni 9

Pas shkronjës “l”, të pikës 1, të nenit 248, shtohet shkronja “m”, me këtë përmbajtje:

“m) targat e mjeteve të shërbimit të konsujve të nderit: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat e gjelbër, shenja dalluese HCC (figurat: III.4/1.r; III.4/2.r; III.4/3.r; III.4/4.r).”.

Neni 10

Në nenin 249 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Përgjithësisht bëjnë targat e personalizuara.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kur targa është e dëmtuar dhe elementet përbërëse të saj janë të dallueshme, lejohet të riprodhohet kur bëhet dorëzimi i saj pranë zyrës përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”.



Neni 11

Në nenin 291 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Certifikatat mjekësore mund të lëshohen dhe përmes ndërveprimit të sistemeve informatike të përshtatshme.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Për pikat 6, shkronjat “b” deri në “dh”, të nenit 117, dhe paragrafit të dytë, të pikës 1, të nenit 124, të Kodit Rrugor, drejtuesi paraqet, kur i kërkohet nga organi kontrollues, një dëshmi të aftësisë psikofizike për kërkesat fizike dhe psikike për kategoritë e lejedrejtimimit që zotëron, pas një vizite të specializuar mjekësore për çdo rast jo më shumë se 1 vit, sipas mënyrave të përcaktuara në aktet në zbatim, e cila është në përputhje me modelin IV.1, që është pjesë përbërëse e rregullores. Dëshmitë e aftësisë psikofizike mund të lëshohen përmes ndërveprimit të sistemeve informatike të përshtatshme.”.

Neni 12

Pas fjalisë së parë, të pikës 2, të nenit 302, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Certifikatat mjekësore mund të lëshohen dhe përmes ndërveprimit të sistemeve informatike të përshtatshme.”.

Neni 13

Në fund të pikës 2, të nenit 309, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Certifikatat mjekësore mund të lëshohen dhe përmes ndërveprimit të sistemeve informatike të përshtatshme.”.

Neni 14

Në nenin 309/1 bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Kufizime për drejtuesit e mjeteve rrugore (neni 117/1 i Kodit Rrugor)”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Mbajtësve të lejeve të drejtimit të kategorisë B, në dy vitet e para të lëshimit, nuk u lejohet të

drejtojnë mjete motorike me fuqi specifike, referuar masës bosh të mjetit, më të madhe se 55 kw/tonë, dhe për makinat hibride elektrike ose plug-in, kufiri specifik i fuqisë është 65 kw/tonë, duke përfshirë peshën e baterisë.

Në lejen e qarkullimit të motomjeteve që kanë kufizime për përdorimin e tyre, sipas pikës 1, të nenit 117/1, të Kodit Rrugor, në rubrikën “Shënime” vihet fjalia: “Neni 117/1 i K.Rr.”.

Në lejen e qarkullimit të automjeteve që kanë kufizime për përdorimin e tyre, sipas pikës 1/1, të nenit 117/1, të Kodit Rrugor, në rubrikën “Shënime” vihet raporti i fuqisë specifike (kw/tonë) dhe fjalia: “Neni 117/1 i K.Rr.”.

Neni 15

Në nenin 311 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) shkronja “b” shfuqizohet.

b) shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) certifikatë mjekësore e kandidatit, që vërteton aftësinë shëndetësore për të drejtuar mjetin rrugor të kategorisë përkatëse, të lëshuar jo më përpara se gjashtë muaj nga data e paraqitjes së kërkesës për t’u regjistruar në autoshkollë. Certifikatat mjekësore mund të lëshohen dhe përmes ndërveprimit të sistemeve informatike të përshtatshme;”.

2. Në pikat 3 dhe 4, togfjalëshi “...10 (dhjetë) ditë...” zëvendësohet me “...5 (pesë) ditë...”.

Neni 16

Në nenin 312/1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikat 2, 3, 3/1, 4 dhe 5, fjala “teorik” hiqet.

2. Në fund të pikës 8 shtohen fjalët “...në testin e teorisë dhe fiton vlerësimin e praktikës.”.

3. Në pikën 9, fjalët “...pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 175/2014...” hiqen.

Neni 17

Në nenin 313 shtohen pikat 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23, me këtë përmbajtje:

“17. Autoshkolla nuk mund të programojë më shumë se 6 (gjashtë) orë mësimi të teorisë për një mësues teorie dhe 8 (tetë) orë mësimi të praktikës në ditë për një instruktor praktike.

18. Për rastet kur përgatitja e kandidatit bëhet në



autoshtetë, juridiksioni i aktivitetit të së cilës nuk është i njëjtë me vendbanimin, dosja e lejes së drejtimit dërgohet në DRSHTRR-në, ku ka vendbanimin aplikuesi, pas përfundimit të përgatitjes dhe marrjes së testimit.

Pagesa e transferimit të dosjes bëhet nga kandidati përpara pajisjes me lejedrejtimi.

19. Strukturat e DRSHTRR-së të marrin në prova teorike dhe praktike çdo kandidat që ka kryer ciklin e plotë të përgatitjes teorike e praktike, ka dorëzuar dokumentacionin e plotë dhe ka paguar tarifat e shërbimit. Pas përfundimit të provave, komisioni plotëson dokumentet, sipas modelit të miratuar nga DPSHTRR-ja.

20. Mjetet rrugore, që përdoren gjatë përgatitjes praktike dhe provave për leje drejtimi, dhe certifikata të aftësisë profesionale përcaktohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin. Mjetet me destinacion apo përdorim për autoshtetë duhet të plotësojnë kushtet teknike dhe të komoditetit. Shërbimi i kontrollit dhe i verifikimit të komoditetit kryhet pranë qendrave të kontrollit teknik.

21. Mësuesit e teorisë duhet të jenë të pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale “mësues teorie”, e cila është e vlefshme si për përgatitjen e kandidatëve për lejedrejtimi, dëshmi dhe certifikata.

Instruktorët e praktikës duhet të jenë të pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale për lejedrejtimi dhe kur përgatit kandidatë për dëshmi dhe certifikata duhet të ketë edhe certifikatën e aftësimin profesional (CAP) ose (DAP), në varësi të kandidatëve që përgatit.

Dëshmitë e aftësisë profesionale për mësuesit e teorisë dhe instruktorët e praktikës të autoshtetëve jepen nga strukturat e DPSHTRR-së, pas testimit përkatës. Përgatitja e tyre bëhet sipas programeve të përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar nga ministri përgjegjës për transportin.

Dëshmia e aftësisë profesionale e mësuesit të teorisë është pa afat. Lëshimi i dublikatit ose pajisja me dëshmi të re bëhet për rastet kur ajo dëmtohet, humbet ose kur zotëruesi i saj ndryshon vendbanimin.

Mësuesit e teorisë duhet të kryejnë kurse trajnimi periodik çdo 5 vjet. Mësuesi, që nuk respekton detyrimet periodike të trajnimit, nuk mund të përfshihet në personelin e një autoshtete.

Kursi i trajnimit periodik për mësues teorie ka për objekt një ose më shumë nga temat e mëposhtme:

a) ruajtjen dhe përmirësimin e aftësive të përgjithshme të mësuesve;

b) ndryshimet rregullatore lidhur me sigurinë rrugore;

c) kërkime të reja në lidhje me fushën e sigurisë rrugore, në veçanti sjelljen e drejtuesve të rinj, duke përfshirë evoluimin e tendencave në shkaqet e aksidenteve;

ç) zhvillimet e reja në metodat e mësimdhënies dhe të të nxënës.

Dëshmia e aftësisë profesionale e instruktorit të praktikës lëshohet për një afat 5-vjeçar, me të drejtë rinovimi. Rinovimi bëhet nëse zotërohen aftësitë e kërkuara fizike e psikike të instruktorit dhe ndiqet kursi i trajnimit periodik.

Kursi i trajnimit periodik për instruktor të praktikës ka për objekt një ose më shumë nga temat e mëposhtme:

a) ruajtjen dhe përmirësimin e aftësive të përgjithshme të instruktorit të praktikës;

b) ndryshimet rregullatore lidhur me sigurinë rrugore;

c) kërkime të reja në lidhje me fushën e sigurisë rrugore, në veçanti sjelljen e drejtuesve të rinj, duke përfshirë ndryshimin e tendencave në shkaqet e aksidenteve.

Të drejtën e pezullimit dhe anulimit të dëshmisë së aftësisë profesionale e ka organi, që e ka lëshuar atë.

Dëshmia e aftësisë profesionale pezullohet me afat nga 1 (një) deri në 3 (tre) muaj, kur mbajtësi i saj kryen shkelje të legjislacionit rrugor.

Anulimi bëhet kur kryhet shkelje e përsëritur e legjislacionit rrugor, shkelje të rënda të etikës dhe sjelljes gjatë ushtrimit të profesionit, kur nuk ndiqet kursi i trajnimit periodik, si dhe kur hiqet kategoria e lejedrejtimit.

DPSHTRR-ja pajis me autorizim të veçantë instruktorin e praktikës për përgatitjen e kandidatëve të autoshtetës në të cilën ai është i punësuar. Në asnjë rast instruktori i praktikës nuk mund të përgatisë kandidatë, të cilët nuk i përkasin autoshtetës së autorizuar.

22. Kur mjeti rrugor mësimor drejtohet nga një kandidat, në të lejohet të hipë edhe një kandidat tjetër përveç instruktorit, ndërsa kur mjeti rrugor është autobus, me të cilin përgatiten persona që do të pajisjen me lejedrejtimi të kategorive D1 dhe D, mund të udhëtojnë vetëm pjesëtarët e të njëjtit grup, por jo më shumë se 8 (tetë) persona.



23. Përgatitja praktike e kandidatëve bëhet sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin.”.

Neni 18

Në pikën 1, të shtojcës X, të përmendur në nenin 245, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën “o”, togfjalëshi “... figurat III.4/1.n, III.4/2.n, III.4/5.n ...” zëvendësohet me “... figurat III.4/1.p, III.4/2.p, III.4/5.p ...”.

2. Në shkronjën “p”, togfjalëshi “... figura III.3.n ...” zëvendësohet me “... figura III.3.p ...”.

3. Në shkronjën “q”, togfjalëshi “... figura III.3/1.n ...” zëvendësohet me “... figura III.3/1.p ...”.

4. Pas shkronjës “q” shtohet shkronja “r”, me këtë përmbajtje:

“r) targat e mjeteve të shërbimit të konsujve të nderit, sipas radhës, stema zyrtare, tri karaktere alfabetike (HCC) dhe 4 numra (figurat III.4/1.r; III.4/2.r; III.4/3.r; III.4/4.r).”.

Neni 19

Lidhja nr. 1, “Tabela e pikëve për shkeljet e normave të sjelljes”, që përmendet në pikën 1, të nenit 312/1, zëvendësohet me lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 20

Në fund të rregullores shtohen: figura III.4/1.n, neni 248; figura III.4/2.n, neni 248; figura III.4/5.n, neni 248; figura III.3/1.n, neni 248; figura III.4/1.p, neni 248; figura III.4/2.p, neni 248; figura III.4/5.p, neni 248; figura III.3/p, neni 248; figura III.3/1.p, neni 248; figura III.4/1.r, neni 248; figura III.4/2.r, neni 248; figura III.4/3.r, neni 248; figura III.4/4.r, neni 248, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Neni 21

Në përmbajtje të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, sipas modeleve VI.1 dhe VI.2, të përmendura në pikat 4 dhe 5, të nenit 349, fjalitë “Likuidimi i gjobës duhet bërë brenda 5 ditëve nga data që vendimi merr formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati për çdo ditë vonesë paguhet 2% kamatë” zëvendësohen me “Kur pagesa bëhet brenda 15 ditëve, pasi vendimi merr formë të prerë, gjoba ulet me 50% të vlerës. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet 2 për qind kamatë deri në një muaj.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Lidhja nr.1

KODI RRUGOR		SASIA E PIKËVE QË DO TË HIQEN	
NENI	PIKA	PËR HERËN E PARË	PËR PËRSËRITJE TË SË NJËJTËS SHKELJE
7	12	6 (gjashtë)	9 (nëntë)
140	9	6 (gjashtë)	8 (tetë)
		9 (nëntë) për drejtues që zotëron lejedrejtimi më pak se 3 vjet	12 (dymbëdhjetë) për drejtues që zotëron lejedrejtimi më pak se 3 vjet
140	9/1	10 (dhjetë)	14 (katëmbëdhjetë)
141	10	10 (dhjetë)	15 (pesëmbëdhjetë)
143	2		Brenda 1 viti 5 (pesë)
143	3		Brenda 1 viti 7 (shtatë)
143	4		Brenda 1 viti 7 (shtatë)
143	5		Brenda 1 viti 7 (shtatë)
143	6		Brenda 1 viti 9 (nëntë)
143	7		Brenda 1 viti 6 (gjashtë)
143	8		Brenda 1 viti 6 (gjashtë)
143	11	5 (pesë)	Brenda 1 viti 8 (tetë)
143	12	8 (tetë)	Brenda 1 viti 12 (dymbëdhjetë)
144	4		3 herë brenda 2 vjetësh 10 (dhjetë)
145	1		Brenda 1 viti 8 (tetë)
145	2		Brenda 1 viti 8 (tetë)



145	3/a		Brenda 1 viti	8 (tetë)
145	3/b		Brenda 1 viti	8 (tetë)
145	3/c		Brenda 1 viti	8 (tetë)
145	3/d		Brenda 1 viti	8 (tetë)
145	4		Brenda 1 viti	8 (tetë)
146	9		Brenda 2 vjetësh	10 (dhjetë)
146	10		Brenda 2 vjetësh	7 (shtatë)
146	11		Brenda 2 vjetësh	7 (shtatë)
146	12		Brenda 2 vjetësh	7 (shtatë)
146	13		Brenda 2 vjetësh	7 (shtatë)
146	14		Brenda 2 vjetësh	8 (tetë)
146	17	8 (tetë)		
155	8	5 (pesë)	Brenda 3 vjetësh	6 (gjashtë)
166	8	12 (dymbëdhjetë)		
170	1	6 (gjashtë)		
170	8	10 (dhjetë)		
171	2	4 (katër)		
171	4	10 (dhjetë)		
174	1/a	15 (pesëmbëdhjetë)		
174	1/c	10 (dhjetë)		
174	1/d	10 (dhjetë)		
175	3	15 (pesëmbëdhjetë)		
175	4	15 (pesëmbëdhjetë)		
177	2	6 (gjashtë)		
184	2/a	4 (katër)		
184	2/a	8 (tetë)		
184	2/b	10 (dhjetë)		
184	2/c, ç	15 (pesëmbëdhjetë)		
184	10	15 (pesëmbëdhjetë)		
185	1	15 (pesëmbëdhjetë)		
185	2	15 (pesëmbëdhjetë)		
187	6	15 (pesëmbëdhjetë)		
187	7	15 (pesëmbëdhjetë)		
187	8	15 (pesëmbëdhjetë)		
190	1	12 (dymbëdhjetë)		
190	2	12 (dymbëdhjetë)		
190	4	12 (dymbëdhjetë)		
190	5	5 (pesë)		




Figura III. 4/1.n, neni 248

Technical drawing of a rectangular sign with dimensions and text. The sign is dark brown with a light brown border. The text 'K O O O A A' is displayed in large, white, sans-serif capital letters. The sign has a total width of 1400 mm and a height of 100 mm. The text is centered horizontally. The drawing includes detailed dimensions for the sign's components, such as the letter height (100 mm), letter spacing (50 mm), and the overall sign dimensions (1400 mm x 100 mm). A small circular detail is shown on the right side of the sign.

Page | 10260



Figura III. 4/2.p, neni 248




Figura III. 4/5.p, neni 248




Figura III. 3/p, neni 248



Figura III. 3/1.p, neni 248




Figura III. 4/1.r, neni 248




Figura III. 4/2.r, neni 248




Figura III. 4/3.r, neni 248




Figura III. 4/4.r, neni 248



VENDIM

Nr. 323, datë 29.5.2024

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.
1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË
BASHKIMIT EVROPIAN PËR
VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË
NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 33, të kreut I, pas fjalëve “... (CFSP) 2024/740 ...” shtohen “... (CFSP) 2024/1242 ...”.

2. Në aneksin 33, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2024/1242, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2024/1242

i datës 26 prill 2024

për ndryshimin e Vendimit (CFSP) 2023/891 në lidhje me masat kufizuese në funksion të veprimeve që destabilizojnë Republikën e Moldavisë

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Më 28 prill 2023, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2023/891 ⁽¹⁾.
- (2) Bashkimi mbetet i palëkundur në mbështetjen e tij për Republikën e Moldavisë dhe qëndrueshmërinë, sigurinë, stabilitetin, ekonominë dhe furnizimin me energji të saj përballë aktiviteteve destabilizuese nga aktorët e jashtëm.
- (3) Në bazë të një rishikimi të Vendimit (CFSP) 2023/891 dhe në funksion të kërcënimit të vazhdueshëm ndaj demokracisë dhe shtetit të së drejtës, si dhe ndaj stabilitetit dhe sigurisë së Republikës së Moldavisë, masat kufizuese në vend duhet të rinovohen deri më 29 prill 2025.
- (4) Bazuar në informacionin e përditësuar, regjistrimet për pesë persona të përfshirë në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve që i nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2023/891 duhet të ndryshohen.
- (5) Vendimi (CFSP) 2023/891 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi (CFSP) 2023/891 ndryshohet si më poshtë:

- (1) në nenin 8, paragrafi i parë zëvendësohet si vijon:
"Ky Vendim do të zbatohet deri më 29 prill 2025".
- (2) Aneksi ndryshohet në përputhje me Aneksin e këtij vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, më 26 prill 2024.

*Për Këshillin
Presidenti*

H. LAHBIB

⁽¹⁾ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2023/891 i 28 prillit 2023 në lidhje me masat kufizuese në funksion të veprimeve që destabilizojnë Republikën e Moldavisë (OJ L 114, 2.5.2023, f.15).



AL

OJ L, 29.4.2024

ANEKS

Në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2023/891, në Seksionin 'A, Personat fizikë, shënimet 1, 2, 5, 6 dhe 7 zëvendësohen me sa vijon:

Emri	Informacion identifikues	Deklarata e Arsyeve	Data e listimit
'1. Ilan Mironovich SHOR alias Ilan Mironovici SHOR	Funksioni: biznesmen, kryetar i partisë politike "SHOR" ("ŞOR") Datëlindja: 6.3.1987 Vendlindja: Tel Aviv, Izrael Gjinia: mashkull Kombësia: moldave, izraelite Numri i identifikimit shtetëror (IDNP): 0971007884125 (Republika e Moldavisë)	Ilan Shor është një politikan moldav (udhëheqës i Partisë Politike ŞOR) dhe biznesmen nga Republika e Moldavisë. I cili është i përfshirë në financimin e paligjshëm të partive politike në Republikën e Moldavisë dhe në nxjehjen e dhunës kundër opozitës politike. Para se të shpallej antikushtetuese në qershor 2023, Partia ŞOR, të cilën e drejton Ilan Shor, ishte e përfshirë në pagesën dhe trajnimin e personave për të provokuar trazira dhe probleme gjatë protestave në Republikën e Moldavisë. Me një vendim të datës 13 prill 2023, Gjykata e Apelit e Kishinau-t e dënoi Ilan Shor për mashtrim dhe pastrim parash në çështjen "Mashtrim bankar" me 15 vjet burgim dhe konfiskim të aseteve për një vlerë prej 254 milionë euro. Fondet nga ky mashtrim bankar në shkallë të gjerë dhe lidhjet me oligarkët e korruptuar dhe subjektet me bazë në Moskë janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren, sipas autoriteteve të Republikës së Moldavisë, për të krijuar artificialisht trazira politike në vend. Veprimet e tij të orientuara drejt përmbyshjes së demokracisë në Republikën e Moldavisë përfshijnë sigurimin e fondeve të paligjshme për të mbështetur aktivitetin politik pro-Kremlinit në Republikën e Moldavisë. Një shembull i përdorimit të fondeve të tilla është organizimi i protestave dhe mitingjeve të dhunshme, kryesisht në kryeqytetin Kishinai, me ndihmën e protestuesve të paguar nga Partia ŞOR, përgjatë viteve 2022 dhe 2023. Pasi Partia ŞOR u shpall antikushtetuese, Ilan Shor vazhdoi të lehtësojë ndikimin rus në skenën politike të Republikës së Moldavisë duke financuar ilegalisht parti të tjera dhe duke u përpjekur të korruptojë politikanët. Duke drejtuar dhe planifikuar demonstrata të dhunshme dhe me sjelljen e tij të paligjshme financiare në lidhje me fondet publike dhe eksportin e paautorizuar të kapitalit, Ilan Shor është përgjegjës për veprimet që minojnë dhe kërcënojnë sovranitetin dhe pavarësinë e Republikës së Moldavisë, si dhe demokracinë, sundimin e ligjit, stabilitetin dhe sigurinë në Republikën e Moldavisë.	30.5.2023



	Emri	Informacion Identifikues	Deklarata e Arsyeve	Data e listimit
2.	Gheorghe Petru CAVCALIUC	Funksioni: politikan, kryetar i partisë politike "Ndertimi i Evropës në Shqipëri" (PACE) ish-zv/drejtnes i Inspektoratit të Përgjithshëm të Policisë Datëlindja: 25.10.1982 Vendlindja: Fshati Micaçui, qarku Strășeni, Republika e Moldavisë Gjinia mashkull Kombësia: moldave, rumune Numri i identifikimit shtetëror (IDNP): 2000033042660 (Republika e Moldavisë) Nr. i pasaportës: AB0664715 (Republika e Moldavisë) 058117566 (Rumani)	Gheorghe Petru CAVCALIUC është ish-zëvendës shefi i Inspektoratit të Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Moldavisë. Ai njihet për organizimin dhe pjesëmarrjen në protestat e dhunshme të tetorit 2022, përkatësisht Ilan Shor. Ai ka përdorur lidhjet e tij brenda Inspektoratit të Përgjithshëm të Policisë për të rekrutuar ish-oficerë policie dhe për të krijuar një grup paraushtarak për të "mbrojtur" demonstruesit e dhunshëm kundër qeverisë së Republikës së Moldavisë. Në këtë kontekst, ai ka themeluar të ashtuquajturën "qeveri në hije" me synimin për të zëvendësuar qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike të Republikës së Moldavisë. Duke drejtuar dhe planifikuar demonstrata të dhunshme, Gheorghe CAVCALIUC është përgjegjës për veprimet që minojnë dhe kërcënojnë sovranitetin dhe pavarësinë e Republikës së Moldavisë, si dhe demokracinë, sundimin e ligjit, stabilitetin dhe sigurinë në Republikën e Moldavisë.	30.5.2023
5.	Vladimir Gheorghe PLAHOTNIUC alias Vladimir ULINICI alias Vladimir PLAKHOT- NYUK alias Vladislav Vladimir NOVAK (Владимир (Влад) Георгиевич ПЛАХОТНИК)	Funksioni: biznesmen, politikan Datëlindja: 1.1.1966 ose 25.12.1965 Vendlindja: Pitușca, Calarasi, ish-BRSS (tani Republika e Moldavisë) Gjinia mashkull Kombësia: moldave, rumune, ruse Numri i identifikimit shtetëror (IDNP): 0962706018030 (Republika e Moldavisë) Nr pasaportës: AB 0671328; AA 1203658 (Republika e Moldavisë)	Vladimir Plahotniuc është subjekt i një sërë procedurash penale në Republikën e Moldavisë në lidhje me krimet për përvetësimin e fondeve shtetërore të Republikës së Moldavisë dhe transferimin e tyre të paligjshëm jashtë Republikës së Moldavisë. Ai u akuzua në Republikën e Moldavisë për çështjen "Mashtrim Bankar", efektet ekonomike të së cilës ende po prekin vendin. Ai po hetohet edhe për rryshfet ndaj ish-presidentit të Republikës së Moldavisë me një cantë me para në këmbim të favoreve politike. Përmes sjelljes së tij të pabujshme financiare në lidhje me fondet publike dhe eksportin e paautorizuar të kapitalit dhe minimin e procesit politik demokratik në Republikën e Moldavisë, Vladimir Plahotniuc është përgjegjës për veprimet dhe zbatimin e politikave që minojnë dhe kërcënojnë demokracinë, sundimin e ligjit, stabilitetin ose sigurinë në Republika e Moldavisë.	30.5.2023



AL

OJ L, 29.4.2024

	Emri	Informacion Identifikues	Deklarata e Arsyeve	Data e listimit
6.	Chiril GUZUN	Ish-oficer i policisë kufitare dhe drejtuesi aktual i një grupi paraushtarak, "MBUROJA E POPULLIT" Datëlindja: 27.4.1979 Vendlindja: Ratus, Crilemi, SSR Moldavi Gjinia: mashkull Kombësia: moldave, rumune	Chiril Guzun është themeluesi dhe udhëheqësi aktual i "Scutul Poporului", një organizatë paraushtarake në Republikën e Moldavisë, duke përfshirë ish-ushtarakë, policë dhe personel të zbatimit të ligjit, e cila përdor dhunë gjatë pjesëmarrjes në protesta, veçanërisht për të destabilizuar Republikën e Moldavisë. Gjatë përjekjeve të shkurtit 2023 për të destabilizuar qeverinë kombëtare, grupet e protestuesve të lidhur me partinë e ndaluar më pas "Partidul ȘOR" dhe Partinë Ndërtimi i Evropës në Shtëpi, "Partidul Acasă Construum Europa" (PACE) u mbështetën dhe u rrethuan nga anëtarë të "Scutul Poporului", të cilët u përfshinë në trazira dhe demonstrata të dhunshme. Chiril Guzun është gjithashtu një njohës prej kohësh i Gheorghe Cavcaliuc, një person i listuar dhe kreu i partisë "PACE". Cavcaliuc pranoi se ishte koordinuar me organizatën e Chiril Guzun në lidhje me protestat e dhunshme. Përveç kësaj, Natalia Guzun, bashkëshortja e Chiril Guzun, është nënkryetare e partisë "PACE". Në rolin e udhëheqësit të "Scutul Poporului", duke drejtuar, përfshirë dhe mbështetur demonstratat e dhunshme, Chiril Guzun është përgjegjës për veprimet që minojnë dhe kërcënojnë sundimin e ligjit, stabilitetin dhe sigurinë në Republikën e Moldavisë. Për më tepër, Chiril Guzun është i lidhur me Gheorghe Cavcaliuc dhe "Scutul Poporului".	22.2.2024



OJ L, 29.4.2024

AL

	Emri	Informacion Identifikues	Deklarata e Arsyeve	Data e listimit
7.	Dmitry MILYUTIN (Дмитрий Милютин)	Zëvendës kreu i Departamentit të Inteligjencës Operative të Drejtorisë 5, Shërbimi Federal i Sigurisë Ruse (FSB) Datëlindja: 30.5.1967 Vendlindja: Jevsk, BRSS (sot Federata Ruse) Gjinia: mashkull Kombësia: ruse Numri i kartës së identitetit: 0134180	Dmitry Milyutin është Zëvendës Shefi i Departamentit të Inteligjencës Operacionale të Shërbimit Federal të Sigurisë Ruse (FSB), përgjegjës për operacionet e fshehta të Rusisë në Republikën e Moldavisë që nga viti 2016, veçanërisht në rajonin e Transnistriës, duke destabilizuar rendin kushtetues. Npërmjet operativeve të tij, Milyutin drejton, koordinon dhe manipulon aktorë të zgjedhur politikë në Republikën e Moldavisë për të ndjekur axhendat pro-ruse, duke minuar kështu procesin politik demokratik në Republikën e Moldavisë. Për më tepër, grupi i Milyutin është i përfshirë në organizimin e protestave të dhunshme dhe akteve të tjera të dhunës që ndodhin në Republikën e Moldavisë. Duke minuar seriozisht procesin politik demokratik, duke u përpjekur të destabilizojë rendin kushtetues dhe duke lehtësuar demonstratat e dhunshme dhe aktet e tjera të dhunës, Dmitry Milyutin po mbështet veprime që minojnë dhe kërcënojnë sovranitetin dhe pavarësinë, demokracinë, sundimin e ligjit, stabilitetin dhe sigurinë e Republikës së Moldavisë. Ai është i lidhur edhe me personin e listuar Igor Chaika.	22.2.2024 ¹ .

ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2024/1242/oj>



2024/1242

29.4.2024

COUNCIL DECISION (CFSP) 2024/1242

of 26 April 2024

amending Decision (CFSP) 2023/891 concerning restrictive measures in view of actions destabilising the Republic of Moldova

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 28 April 2023, the Council adopted Decision (CFSP) 2023/891 ⁽¹⁾.
- (2) The Union remains unwavering in its support for the Republic of Moldova and its resilience, security, stability, economy and energy supply in the face of destabilising activities by external actors.
- (3) On the basis of a review of Decision (CFSP) 2023/891 and in view of the continuing threat to democracy and the rule of law, as well as to the stability and security of the Republic of Moldova, the restrictive measures in place should be renewed until 29 April 2025.
- (4) Based on updated information the entries for five persons included in the list of natural and legal persons, entities and bodies subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision (CFSP) 2023/891 should be amended.
- (5) Decision (CFSP) 2023/891 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Decision (CFSP) 2023/891 is amended as follows:

- (1) in Article 8, the first paragraph is replaced by the following:
"This Decision shall apply until 29 April 2025.;"
- (2) the Annex is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 26 April 2024.

For the Council

The President

H. LAHBIB

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2023/891 of 28 April 2023 concerning restrictive measures in view of actions destabilising the Republic of Moldova (OJ L 114, 2.5.2023, p. 15).



EN

OJ L, 29.4.2024

ANNEX

In the Annex to Decision (CFSP) 2023/891, in Section 'A. Natural persons', entries 1, 2, 5, 6 and 7 are replaced by the following:

	Name	Identifying information	Statement of Reasons	Date of listing
'1.	Ilan Mironovitch SHOR a.k.a. Ilan Mironovitch ŞOR	Function: businessman, president of the political party "ŞHOR" ("ŞOR") DOB: 6.3.1987 POB: Tel Aviv, Israel Gender: male Nationality: Republic of Moldova, Israeli State Identification Number (IDNP): 0971007884125 (Republic of Moldova)	Ilan Şor is a Moldovan politician (leader of the ŞOR Political Party) and businessman from the Republic of Moldova who is involved in the illegal financing of political parties in the Republic of Moldova and in incitement to violence against the political opposition. Before being declared unconstitutional in June 2023, the ŞOR Party, which Ilan Şor leads, was involved in the payment and training of persons in order to provoke disorder and unrest during the protests in the Republic of Moldova. By a decision dated 13 April 2023, the Court of Appeal of Chişinău sentenced Ilan Şor for being guilty of fraud and money laundering in the "Bank Fraud" case to 15 years of imprisonment and the confiscation of assets for a value of EUR 254 million. Funds from this large-scale banking fraud and connections to corrupt oligarchs and Moscow-based entities have been and are still being used, according to authorities of the Republic of Moldova, to artificially create political unrest in the country. His actions directed towards subverting democracy in the Republic of Moldova include providing illegal funding to support pro-Kremlin political activity in the Republic of Moldova. An example of the use of such funds is the organisation of violent protests and rallies, primarily in the capital Chişinău, with the help of protestors paid by the ŞOR Party, throughout 2022 and 2023. After the ŞOR Party was declared unconstitutional, Ilan Şor continued to facilitate Russian influence on the political scene of the Republic of Moldova by illegally financing other parties and attempting to bribe politicians. By directing and planning violent demonstrations and through his serious financial misconduct concerning public funds and the unauthorised export of capital, Ilan Şor is responsible for actions which undermine and threaten the sovereignty and independence of the Republic of Moldova, and the democracy, the rule of law, stability and security in the Republic of Moldova.	30.5.2023



	Name	Identifying information	Statement of Reasons	Date of listing
2.	Gheorghe Petru CAVCAIUC	Function: politician, president of the political party "Building Europe at Home Party" (PACE) former Deputy Head of the General Police Inspectorate DOB: 25.10.1982 POB: Micăuți village, Strășeni county, Republic of Moldova Gender: male Nationality: Republic of Moldova, Romanian State Identification Number (IDNP): 2000033042660 (Republic of Moldova) Passport no: AB0664715 (Republic of Moldova) 058117566 (Romania)	Gheorghe Petru Căvăliuc is the former Deputy Head of the General Police Inspectorate of the Republic of Moldova. He is known for having organised and participated in the violent protests of October 2022, alongside Ian Șor. He has used his connections within the General Police Inspectorate to recruit former police officers and create a paramilitary group to "protect" the violent demonstrators against the Government of the Republic of Moldova. In this context, he has founded a so-called "shadow government" with the aim of replacing the democratically elected government of the Republic of Moldova. By directing and planning violent demonstrations, Gheorghe Căvăliuc is responsible for actions which undermine and threaten the sovereignty and independence of the Republic of Moldova, and the democracy, the rule of law, stability and security in the Republic of Moldova.	30.5.2023
5.	Vladimir Gheorghe PLAHOTNIUC a.k.a. Vladimir ULINICI a.k.a. Vladimir PLAKHOT- NYUK a.k.a. Vladislav Vladimir NOVAK (Владимир (Ван) Георгиевич ПЛАХОТНИК)	Function: businessman, politician DOB: 1.1.1966 or 25.12.1965 POB: Pitușca, Călărași, former USSR (now Republic of Moldova) Gender: male Nationality: Republic of Moldova, Romanian, Russian State Identification Number (IDNP): 0962706018030 (Republic of Moldova) Passport no: AB 0671328; AA 1203658 (Republic of Moldova)	Vladimir Plahotniuc is subject to numerous criminal proceedings in the Republic of Moldova related to crimes in connection with the embezzlement of State funds of the Republic of Moldova and their illegal transfer outside the Republic of Moldova. He was accused in the Republic of Moldova in the "Bank Fraud" case, the economic effects of which are still affecting the country. He is also being investigated for bribing the former president of the Republic of Moldova with a bag of cash in exchange for political favours. Through his serious financial misconduct concerning public funds and the unauthorised export of capital and undermining the democratic political process in the Republic of Moldova, Vladimir Plahotniuc is responsible for actions and implementing policies which undermine and threaten democracy, the rule of law, stability or security in the Republic of Moldova.	30.5.2023



EN

OJ L, 29.4.2024

	Name	Identifying information	Statement of Reasons	Date of listing
6.	Chiril GUZUN	Former border police officer and the current leader of a paramilitary group, "SCUTUL POPORULUI" DOB: 27.4.1979 POB: Ratus, Criuleni, SSR Moldova Gender: male Nationality: Republic of Moldova, Romanian	Chiril Guzun is the founder and current leader of the "Scutul Poporului", a paramilitary organisation in the Republic of Moldova, including former military, police and law-enforcement personnel, which uses violence while attending protests, particularly to destabilise the Republic of Moldova. During the attempts of February 2023 to destabilise the national government, groups of protesters affiliated to the subsequently-banned "Partidul ŞOR" and to the Building Europe at Home Party, "Partidul Acasă Construi Europe" (PACE) were supported and surrounded by members of the "Scutul Poporului", who were involved in riots and violent demonstrations. Chiril Guzun is also a long-time acquaintance of Gheorghe Cavaliuc, a listed person and the leader of the "PACE" party. Cavaliuc admitted to coordinating with Chiril Guzun's organisation regarding the violent protests. In addition, Natalia Guzun, the wife of Chiril Guzun, is vice-president of the "PACE" party. In the role of "Scutul Poporului" leader, by directing, engaging in and supporting violent demonstrations, Chiril Guzun is responsible for actions which undermine and threaten the rule of law, stability and security in the Republic of Moldova. Furthermore, Chiril Guzun is associated with Gheorghe Cavaliuc and "Scutul Poporului".	22.2.2024



	Name	Identifying information	Statement of Reasons	Date of listing
7.	Dmitry MILYUTIN (Дмитрий Милютин)	Deputy head of the Department of Operational Intelligence of Directorate 5, Russian Federal Security Service (FSB) DOB: 30.5.1967 POB: Ijensk, USSR (now Russian Federation) Gender: male Nationality: Russian ID Card Number: 0134180	Dmitry Milyutin is the Deputy Head of the Russian Federal Security Service (FSB)'s Department of Operational Intelligence, responsible for Russia's covert operations in the Republic of Moldova since 2016, especially in the Transnistria region, destabilising the constitutional order. Through his operatives, Milyutin directs, coordinates and manipulates chosen political actors in the Republic of Moldova in order to pursue pro-Russian agendas, thus undermining the democratic political process in the Republic of Moldova. Furthermore, Milyutin's group is involved in organising violent protests and other acts of violence taking place in the Republic of Moldova. By seriously undermining the democratic political process, attempting to destabilise the constitutional order, and by facilitating violent demonstrations and other acts of violence, Dmitry Milyutin is supporting actions which undermine and threaten the sovereignty and independence, democracy, rule of law, stability and security of the Republic of Moldova. He is also associated with the listed person Igor Chaika.	22.2.2024 ⁴ .

**VENDIM****Nr. 324, datë 29.5.2024****PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË INTEGRUAR TË VEPRIMTARIVE, NË KUADËR TË VITIT MBARËKOMBËTAR TË 80-VJETORIT TË ÇLIRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 6, të vendimit nr. 32, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e vitit 2024 ‘Viti mbarëkombëtar i 80-vjetorit të Çlirimit’ dhe krijimin e komisionit shtetëror për organizimin e veprimtarive në kuadër të tij”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të integruar të veprimtarive në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të 80-Vjetorit të Çlirimit, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, nga fondi rezervë i buxhetit, u shtohen fonde për

zhvillimin e disa aktiviteteve, sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, si më poshtë:

a) Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i shtohet fondi prej 5 500 000 (pesë milionë e pesëqind mijë) lekësh në programin “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, në llogarinë ekonomike 602;

b) Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit i shtohet fondi prej 17 720 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet mijë) lekësh në programin “Arti dhe kultura”, fonde korrente në llogarinë ekonomike 604.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga ky vendim, me përjashtim të atyre të përmendura në pikën 2, të këtij vendimi, që përballohen nga fondi rezervë i buxhetit, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për çdo institucion.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Biblioteka Kombëtare dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LIDHJA I								
Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i Aktivitetit	Institucioni propozues	Në bashkëpunim me	Periudha e realizimit	Burimi i financimit	Kostot e përafërta (në lekë)	Nga fondet rezervë i Buxhetit të Shtetit
1	Shtafje filmash dhe diskutim mbi problematikat që trajtojnë veprat kinematografike të shfaqura	Dallimet që na bashkojnë do të jetë tema e aktivitetit që bashkëpunim mes AQSHF dhe Kinoteks së RMV në Shkup ku do të shfaqen filmat Luftëtarët mbi mure (Asgarosti 1978) dhe Uj i madh (Ivo Trajkov 2003) si dhe do të ketë diskutime mbi këto dy vepra kinematografike. Problematikat që trajtohen në këto filma kanë shumë pika të përbashkëta (tek dy filmat në pikënamë janë filmjesh në jetimorë, indoktrinimi në ideologjië e kohës dhe lufta për liri etj)	Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	Shkup, RMV	25.04.2024	Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	-	-
2	Konferenca Kombëtare për rindërsinë e historisë në kontekste të reja 80-vjetori i Gjirmimit dhe historia	Konferenca kombëtare me historianë, profesorë, akademikë që do të jenë të pranishëm në këtë ngjarje, e cila kërkon të rikthejë në diskutim publik rindërsinë e historisë në kontekste të reja shoqërore e kulturore dhe rolin e së shkuarës.	QKLL	At Shkencave SHQ-KS	27.04.2024	QKLL	-	-
4	Konkurs letrar për "Novelat Grafike" mbi klimin shqiptar.	Konkursi letrar për autorë të rinj "Novelat Grafike" bazuar mbi temën e klimin shqiptar	MEK	MEK	01.05.2024	MEK	-	-
5	Dita e koleksioneve "Collection DAY" të kujtimeve dhe suvenireve nga lufta	Aktivitetë ku mnenist mbledhin kujtime, suvenire që lidhen me luftën	Ministria e Arsimit dhe Sportit	DPAP, JA	01.05.2024	IMAS	-	-
6	Kampionate sportive për Kupën "80 Vjetori i Gjirmimit" në futboll, voleyboll, dhe basketboll.	DPAP/ZVAP/DPAP organizojnë kampionatet në futboll, voleyboll, basketboll për kupën "80 Vjetori i Gjirmimit".	Ministria e Arsimit dhe Sportit	KOKSH, DPAP	01.05.2024	IMAS	-	-
7	Memoriali për Dëshmorët e Policisë në 5 Maj; Ceremoni, Takime, dhe Koordinim me pushtetin vendor për restaurimin e varrezeve.	Organizimi i ceremonive, takim për kujtimor, vendosje kuroresh, nga cdo strukturë qendrore dhe vendore në përkujtim të Dëshmorëve. Realizimi i vizitave në familjet e Dëshmorëve të Policisë. Koordinimi me institucionet e pushtetit vendor për restaurimin e varrezeve apo memorialeve kushuar Dëshmorëve të Policisë	Policia e Shtetit	Drejtoritë Vendore të Policisë Pushëtit Vendor	05.05.2024	Policia e Shtetit	200.000	-
8	Bibliotekë e hapur me materiale të lexueshme, shoqëruar me instalacione të foto dhe video dokumentare.	Biblioteka hapet në një ekspozitë , ku gazeta ose libra që flasin për këtë temë, të jetë e vendosur për t'u lexuar e parë nga publiku, në tavolina të mëdha të përbashkëta, shoqëruar me foto dhe video dokumentare si instalacione.	BK	BK	20.05.2024	IHK	-	-
9	Shkrimtarë e luftës; Aktivitete për të rikthyer vëmendje, duke përfshirë edhe emra të letërsisë bashkëkohore.	Një cikël aktivitetesh me në fokus shkrimtarë që kanë shkruar një vepër kushuar Luftës së Dytë Botërore dhe roli të Shqipërisë në këtë tablo historike. Përmes aktiviteteve të dedikuara do të rikthehen në vëmendje autorë që nuk jetojnë më, por që i kanë kushuar një pjesë të veprimtarisë së tyre luftarë, por dhe emra të letërsisë bashkëkohore që në artin e tyre janë grishur nga historia. Ky cikël aktivitetesh kërkon ta sjellë temën e luftës në këtë 80-vjetor në diskutim publik.	QKLL	MEK	25.05.2024	QKLL	-	-
10	Gratë e Trashëgimisë: Evidentimi i Kontributit të personaliteteve të mëdha Pas Luftës së Dytë Botërore	Evidentimi i personaliteteve të mëdha me kontribut pas Luftës II Botërore në fushën e trashëgimisë kulturore, jetësore e misioneve arkeologjike nënra në qendrën kryesore, si Aleksandër Mito, Ilirija Spahiu (Komani, Korçë, etj) dhe në bashkëpunim të studentit të monumenteve të kulturës, si Viktoria Prodanova, Drita Dhamo, në pikurë mure, Pallatit Shkup me skulpturë dekorative në dru, etj. Aktiviteti mbi të përfaqësojë fëmijë të shtetë paqes të forcës, përmbledhje të sadimeve, etj.	IKTK	MEK	28.05.2024	IKTK	-	-
11	Video e animuar për filmjesh me personazhe model frymëzimi dhe histori që transmetojnë vlerat e guximt, sakrificës, dashurisë për atdheun, lirisë dhe paqes.	Bashkëpunimi i historisë në një mënyrë që është e kuptueshme për familjet, duke përfshirë personazhe dhe histori që transmetojnë vlerat e guximt, sakrificës dhe dashurisë për atdheun. Bashkëpunimi i personazheve të animuar që përfaqësojnë luftëtarë e lirshë, të cilët frymëzojnë mund t'i shohin si modele frymëzimi. Ndërmjet historisë, të transmetohen mesazhe rreth rëndësisë së paqes, lirisë, dhe rëndësisë së bashkëpunimit për të arritur qëllime të mëdha.	MSHRE, MEK	MEK	01.06.2024	Fondet rezervë i Buxhetit të Shtetit , implementohet nga MEK	510.000	510.000



12	Organizimi i Konferencës 8-të Shkencore Mbrojtëse Aktore në Elbasan: Sesion Shkencor për LANCL.	Pranimi abstrakteve, vlersimi i tyre Pripa e pjesëmarrësve. Zhvillimi i Konferencës në qytetin e Elbasanit.	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	DPA, Agjencia Shërbimore e Arkivave të Kosovës, Bashkia e Elbasanit, studiues, historianë	08.06.2024	DPA	-	
13	Bashkëpunimi DoArt dhe AQSHF në Festivalin e 6-të të Artistëve të Rugës	Në edicionin e 6 të Tirana Street Artists Festivali organizuar nga qendra kulturore DoArt, AQSHF do të bashkëpunojë me shfaqjen e filmave me temë nga lufta dhe krimet kreative me artistët e rugës, të frymëzuara nga tematika e herot që lufton për lin.	Arkivi Qendror Shërbimor i Filmit	Bashkia Gjakastër	15.06.2024	iv Qendror Shërbimor i Fil	-	
14	Initiativa për Trashëgiminë e Julliarëve të Çirmit të Shqipërisë: Tëpërkje Vullnetarizmi Komunitar	Projekti vullnetarizmi ose iniciativa shërbimi idëj gjelbra, në afërsisht të trashëgimisë së dytë që lulla për çirmin e Shqipërisë. Këto iniciativa mund të përfshijnë aktivitetet, si p.sh. i vendosje historike ose pjesëmarrja të vlerave kulturore, etj.	Ministria e Përbashkme	Ministria e Brendshme	01.07.2024	Ministria e Brendshme	-	
15	Tëpërkje të mediave sociale për 80-vjetorin e çirmit	Përkrahja platformave mediave sociale për të ndaluar faktet historike, histori personale dhe mesazhe kujtimore tihur me 80-vjetorin e çirmit, duke ngritur publikun dhe instur një ndëgjy këmbë dhe uniteri kombëtar.	Ministria e Përbashkme	Ministria e Brendshme	01.07.2024	Ministria e Brendshme	-	
16	Ceremoni për Vendejën e Eshtirave të Dëshmorëve të Policisë në Varrezat e Adhuit dhe Koordinimi për Vendejën e Eshtirave të Dëshmorëve të Tjerë Polici.	Organizimi i Ceremonive për t'u vendosur në Varrezat e Dëshmorëve të Adhuit eshtirë e 6 Dëshmorëve nga radhët e Policisë së Shtetit, 5 nga Qarku i Tiranës dhe 1 nga Qarku i Durrës, të miratuar nga Komisioni Qendror Koordinimi me institucionet përkatëse që edhe Dëshmorët e tjerë nga radhët e policisë të prehen tek varrezat e Dëshmorëve të Adhuit.	Policia e Shtetit	Komisioni Qendror, Bashkia e Tiranës dhe Institucionet e Varësës, Prefekti i Qarkut të Durrës dhe Bashkia, Institucionet vendore në çdo qark	01.07.2024	Policia e Shtetit	1,200,000	
17	Elapozja e Monumentit të Dëshmuesit të Luftës së Dytë Botërore, Shënimor nga Forcimi i Yjetit dhe Materiale Arkivore	Monastiri i 40 Martirëve të Sakës, Vllamja e Sulltanit Pasha Bagjirit në Tiranë, gjithë ekspozita dhe shfaqjet nga imazhet, fotografitë e jetës, materiale grafike dhe arkivore, tekste përshkuese, të cilat do të pasqyrojnë historikun dhe vlerat e tyre	IKTK	MEKI	01.07.2024	IKTK	-	
18	Intervista dhe biseda me shkrimtarë, historianë dhe veteranë të LANCL	Shollat organizonë biseda me shkrimtarë, historianë dhe veteranë të LANCL në data të shënuara si 9 maj dhe në festat e nentorit.	Ministria e Arsimit dhe Sportit	DPAP	01.08.2024	MAS	-	
19	Gusht e n'fest shfaqje dhe performanca DoArt dhe AQSHF	AQSHF do të bashkëpunojë me DoArt për të shfaqur filma me tematikën e luftës në aktivitetin Gusht e n'fest, që zhvillohet çdo muaj gusht në Gramsh, Elbasan.	Arkivi Qendror Shërbimor i Filmit	Bashkia Gramsh	01.08.2024	iv Qendror Shërbimor i Fil	-	
20	Ekspozite me fotografi dhe piktura nga fonde artistike private të familjeve	Ministria e Mbrojtjes do të organizojë një ekspozitë me foto dhe piktura me tematikë lufte nga fonde private të familjeve patriotike në vend.	Ministria e Mbrojtjes	QKMB, DPA	01.09.2024	Ministria e Mbrojtjes	830,000	
21	Drama - Vënie në skenë teatrore (levizje)	"20 ditë" dramë nga Fadi Pajrami "Familja e prishetur" - Sulejman Pllarka "Hyet e natës" - Vendi kokona	Ministria e Mbrojtjes	Qendër Qark	01.09.2024	Ministria e Mbrojtjes	5,400,000	
22	55 Vjetori i Ttullimit "Oficere" të grave të Ushtrisë Shqiptare	Grupi i punës nga QKMB/MFA do të merret me organizimin e aktivitetit si mirënjohje për kontributin e dhënë gjatë vitëve.	Ministria e Mbrojtjes	Qendra Kulturore e Fa	01.09.2024	Ministria e Mbrojtjes	280,000	
23	Podcast me tematikë nga ngjarje e data të shënuara të Luftës Antifashiste Nacionalizmatore	Evidencimi i personave materialit Montimi Shfaqja e materialit në mjedet e komunikimit të DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave/MM	MM, Akademikë, Studiues, historianë, arkivistë	01.09.2024	DPA	-	



24	Evente rinore me kenge patriotike te ramikuaro, ne 6 qytete	Dj bashkohore ne kala apo sheqe te qyteteve te tjera , kod veshjesh dhe pjesh per tu sjelle tak te rinjve proven e historise artistike qe ka lene apo kane ne nje format me prane kohes:Trane, Korçe, Vore, Gjakaster, Berat, Shoder.	MEK/MM		Pushket vendor	01.09.2024	Fondi rezervi Bashketit te Shkruar, implementon MEK	3,018,000	3,018,000
25	Lkjoonte e hapur: Muaji i Momnaneve Historike	Te gjitha monumentet historike do te jene te aksesueshme per publikun nlekoheshist . Peshkrima, materialet grafike dhe fotografike, vendosje ne plan, peshkrima ta historikut te tyre, sa bashko me nje hyrje te pergjithshme historike rreth peritidhes	IKTK		MEK	01.09.2024		-	
26	Vizita ne muze dhe ne vendet e kulteses se te rrene per atdhe	Oganizimi i vizitave me nvenesit ne muze dhe ne vendet e kulteses se te rrene per atdhe, sipas kalendareve te peshktuar ne baze shkolle dhe ZVAP-je.	Ministria e Arsimit dhe Sportit		DPAP	01.09.2024	MAS	-	
27	Koncert me kenge partizane QOMBINATA dhe AQSH	Arkivi Qendror Shetektor i Filmit ne bashkellupim me Qendren e Kulturës, Medias, Botimeve ta Mbrojtjes dhe Muzeit te Forcave te Armatosura do ta shfaqin nje koncert me kenge partizane te mbledhura dhe redaktuara nga Baki Kongoli dhe muziken e filmave me teme raga lufta, ta performuar nga Ansambli i FA.	Arkivi Qendror Shetektor i Filmit		Bashkia Trane	23.09.2024	ivi Qendror Shetektor i Fil	-	
28	Shfaqja dhe diskutimi i dokumentareve, filmave me teme nga Lufta e II Boterore ne kuadrit ta dateve te shenuara historike.	Ne kuadrit te dateve te shenuara historike ne shkolle do te organizohen diskutime dhe shfaqje te dokumentareve ose pamjeve arkivore qe lidhen me Lufta se Dytë Boterore.	Ministria e Arsimit dhe Sportit		DPAP	01.10.2024	MAS	-	
29	Podcast: "Heronjtë që na frymëzojnë"	Podcaste ku shkollet ta organizojne biseda me shkrimtarë, historianë, gazetarë, ushtarakë etj., ku ta flasin për tema që lidhen me heronjtë që na frymëzojnë.	Ministria e Arsimit dhe Sportit		DPAP/Shkollet	01.10.2024	MAS	-	
30	Konkurse me ese për ngjarjet e II.B me nvenesit e shkolleve te meime	Organizimi i nje konkursi me ese me tema historike te II.B ne baze shkolle dhe ZVAP-je, me nvenesit e shkolleve te meime.	Ministria e Arsimit dhe Sportit		DPAP	01.10.2024	MAS	-	
31	"Një ditë në ushtri"	ZVAP do te organizojne ne zonat e tyre, vizita te nvenesve ne njediset e reparative ushtarake ose ne Muzeun e Armeve apo edhe ne Ministrise se Mbrojtjes.	Ministria e Arsimit dhe Sportit		DPAP/MM	01.10.2024	MAS	-	
32	Album "Këngë patriotike të luftës së dytë boterore"	Dahjalizimi melodive, Redaktimi dhe peshktaja e teksteve.Ohetrimet për formacione te ndryshme, vena e tyre ne funksion dhe te aktivitetit propozuar nga MEK" "Disqe Gramofoni"	Ministria e Mbrojtjes		MEK, Akademia e Shkencave Instituti i Historisë, ITSH	01.10.2024	Ministria e Mbrojtjes	920,000	
33	Konkursi letrar për autorët e rinj me temën: "Qytetet e padukshme"	"Qytetet e padukshme" do të jetë një temë, e cila kërkon të elaborojë qytetin në të gjitha kontekstet e mistereve të tij, për të udhëtuar në kohë, në ngjarjet e historit që japin atij dimensionin e kohës. Duke e parë luftën nacional-çlirimtare si një pjesë të rëndësishme të historisë së krijimit të tij, ky konkurs i cili do t'u drejtohet të rinjve, synon jo vetëm nxjelljen e kureshtjes ndaj së shkuarës, por dhe motivimin e autorëve të rinj drejt shkrimit. Temat historike gjithnjë kanë qenë pjesë e laboratorit krijues të shkrimtarëve.	OKLL		MEK, MAS,	01.10.2024	OKLL	-	
34	Botimi i librit "Dhura Leka" ne perkujtim te 100 vjetorit	Botimi i librit, ne perkujtim te 100 vjetorit te kompozitorit Dhura Leka me te gjitha leksat e autoritare te kompozitorit prej saj leksat e autoritare te kompozitorit dhe ngratimit e aktivitetit te bolimit dhe promovimit te librit.	Ministria e Mbrojtjes		Qendra Kulturore e FA	01.10.2024	Ministria e Mbrojtjes	480,000	



35	Tur koncertor në 12 tançe Shqipëri koncerti me albumin patriotik, filmat historikë, hymnet e brigadave	Koncert me albumin e pleshës patriotike Kolana tanore të filmave më të spikatur që evolojnë periudhën e luftës antifashiste Hymnet e brigadave (dixitalizimi dhe orkestrimi i tyre enkas për këtë përvojë)	Ministria e Mbrojtjes	Qendra Kulturore FA (CSFA/OFFA), Qendër Qark	11.10.2024	Ministria e Mbrojtjes	2,200,000	
36	Dyqet gramfonit me muzikë nga filmat shqiptarë të luftës për dhurim në tyra aventurë dhe ambasada si shtetë për delegacione.	Riprodhimi i Muzikës së filmave shqiptarë me tematikë luftë realizuar në dyqet gramfonit për t'ju shpërndarë në minishti, kryeministri i miasada si dhurata suverene për delegacione.	MEK/MM	AQSHF, MM, TKG8 etj	21.10.2024	Fondi rezervë i Bujshetit të Shetit	3,662,000	3,662,000
37	Nisma "Une Jam Shqiptar". Promovimi në Rrjetet Sociale	•Bëjimi i videove: "Une Jam Shqiptar sepa..." ose "Sigurimi që une jam shqiptar se..." - të rinjtë postojnë video të shkurtër për të notur krenarinë kombëtare dhe promovuar kulturën përmas rrjetet sociale. •Bërdorimi i hashtagut #UneJamShqiptar Challenge për të unifikuar dhe promovuar postimet. •Bëjimi me "Ambasadorët e Rinj" në terren.	MSHRE/MEK	MEK	01.10.2024-31.11.2024	Fondi rezervë i Bujshetit të Shetit, implementon MEK	1,530,000	1,530,000
38	Ndërveprim me komandantët për rolin e policisë dhe rebelimit të 80-vjetorit të çlirimit.	Zyra të hapura në Komandantët e Policisë, ku oficerët angazhohen me qytetarët dhe diskutueshëm rëndësia e 80-vjetorit të çlirimit dhe rolin e forcave të ligjit, për sigurinë e vendit publik.	Ministria e Brendshme	me Ministrinë e Asistimit	01.11.2024	Ministria e Brendshme	-	
39	Ekspozita historike që tregojnë historinë e luftës për çlirimin e vendit, duke përfshirë arte-fakte, fotografat e dokumente. Mënd të zhvillohen në ambientet e policisë ose të bashkëpunimit me muze vendore.	Ekspozita/pezuazime që tregojnë historinë e luftës për çlirimin e vendit, duke përfshirë arte-fakte, fotografat e dokumente. Mënd të zhvillohen në ambientet e policisë ose të bashkëpunimit me muze vendore.	Ministria e Brendshme	me Akademinë e Sigurisë dhe VVJ-je	01.11.2024	Ministria e Brendshme	-	
40	Ribotimi i albumit me foto e dokumente arkivore me titull "Resistencë e popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore	Perzgjedhja e dokumenteve apo fotove që nevojiten për plotësim, Botimi dhe prezantimi i botimit në Paranim e Lirët.	Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave/MM	Bashkëpunim DPA me Ministrinë e Mbrojtjes	01.11.2024	Ministria e Mbrojtjes	3,000,000	
41	Ribotimi i përmbledhit me dokumente me titull "Heronjtë e Luftës Antifashiste Nacionalizmitare"	Perzgjedhja e dokumenteve apo fotove që nevojiten për plotësim, Botimi dhe prezantimi i botimit në Paranim e Lirët.	Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave/MM	Bashkëpunim DPA me Ministrinë e Mbrojtjes	01.11.2024	Ministria e Mbrojtjes	2,500,000	
42	Ekspozitë (levizshme) me dokumente arkivore dhe foto nga periudha e Luftës Antifashiste	Perzgjedhja e dokumenteve e fotove Dokumenta të ndryshme, Printime Prinditje e ekspozitë në qytete të vendit me data të rëndësishme të JANDU Fotografji të personazheve historikë të periudhës së Luftës	Ministria e Mbrojtjes/Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave	MM Bashkinë Tiranë, Durrës, Berat, Përmet	01.11.2024	DPA	-	
43	Konkurs kombëtar "Dokumentet im" për dokumentet personale në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit	Perzgjedhja e shkollave, përzgjedhja e nënësive, vlerësimi i punimeve, shpërndarja e çmimeve	Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave	Ministrinë e Arsimt dhe Sporteve/Drejtorja e Komunikimit (DPA)	01.11.2024	DPA-se dhe MAS	-	
44	Video historike me dokumente arkivore të MEPJ gjatë periudhës së Luftës dhe Çlirimit të Shqipërisë, korrespondencat e asaj periudhë etj, të cilat do të pasqyrohen në të gjithë platformat digjitale të MEPJ dhe përfaqësive diplomatike	Video historike me dokumente arkivore të MEPJ gjatë periudhës së Luftës dhe Çlirimit të Shqipërisë, korrespondencat e asaj periudhë etj, të cilat do të pasqyrohen në të gjithë platformat digjitale të MEPJ dhe përfaqësive diplomatike	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme		01.11.2024	MEPJ	-	-
45	Platformat digjitale	Aktivitet me veteranet ose pasardhësit e tyre dhe Tripan Diplomatik	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme		01.11.2024	MEPJ	-	-
46	Video të shkurtër në format Real me familjare të dëshmoreve të luftës	Video të shkurtër në format Real me familjare të dëshmoreve apo dëshmoreve të luftës që jetojnë jashtë vendit	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme		01.11.2024	MEPJ	-	-
47	Ekspozita për Luftën e Dytë Botërore	Krijimi i ekspozitave në bazë shkolle me monumente historike dhe kulturore, kushtuar datave historike dhe dëshmoreve të luftës Nacional-Çlirimtare.	Ministria e Arsimt dhe Sportit	DPAP	01.11.2024	MAS	-	-



48	Ekspozita historike dhe artistike	Cdo ZVAP do të organizojë hapjen e një ekspozite historike ose shfaqje artistike, dokumente, fotografji dhe relike që lidhen me jetimin e vendit gjat Luftës së Dytë Botërore ose me ato të vendeve memoriale ushtarake në Shqipëri.	Ministria e Arsimit dhe Sportit	DPAP/ASCAP	01.11.2024	MAS	-	-
49	Pinair Kombëtar me temë: "Të mësojmë nga historia e brezave"	Organizimi i paneleve në nivel DPAP, me punime të ndërtuara me temë: "Të mësojmë nga historia e brezave".	Ministria e Arsimit dhe Sportit	DPAP	01.11.2024	MAS	-	-
50	Festojmë 28-29 Nëntorin	Organizimi i aktivitetesh kulturore-artistike në nivel shkolle dhe qyteti.	Ministria e Arsimit dhe Sportit	DPAP/Grupi i punës	01.11.2024	MAS	-	-
51	Simpozium me temë/tematika që trajtojnë ngjarje të LANÇL	Organizimi i një simpoziumi me rrethet profesionale të ndëruara të historisë me temë/kumtesa që trajtojnë ngjarjet e LANÇL	Ministria e Arsimit dhe Sportit	ASCAP/DPAP	01.11.2024	MAS	-	-
52	Ekspozitë "80-vjetori i çlirimit të Shqipërisë në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare"	Ekspozita do të organizohet në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Ajo do të paraqesë ngjarjen në këndvështrimin e studimeve shqiptare e të huaja	BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISE		25.11.2024	BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISE	60,000	-
53	Takim për kujtimor në kuadër të 80 vjetorit të Çlirimit	Takim me studentë dhe kursantë të Akademisë së Sigurisë	Policia e Shtetit	Akademia e Shkencave Universiteti i Tiranës	27.11.2024	Policia e Shtetit	-	-
54	Koncert gahu, vokal, operistik dhe balet nga TKOBAP	Treguri që sollën Luftën (Korce, Gjirokastra)	TKOBAP	MM	27.11.2024	Fondi rezervë i Buxheut të Shtetit	3,686,000	3,656,000
55	Koncerte gahu, vokal, operistik dhe balet nga TKOBAP	Oshakima e muleve (Tiranë, Shkoder)	TKOBAP	MM	28.11.2024	Fondi rezervë i Buxheut të Shtetit	1,416,000	1,366,000
56	Koncerte gahu, vokal, operistik dhe balet	Plaga e dhjetë e "Gjirgji, Dësh Aliut" (Gjirkastra)	TKOBAP	MM	11.05.2024	TKOBAP	-	-
57	Koncerte gahu, vokal, operistik dhe balet nga TKOBAP	Nëntori i yjeve të arta (Fier, Tiranë)	TKOBAP	MM	29.11.2024	Fondi rezervë i Buxheut të Shtetit	2,476,000	2,446,000
58	Koncert "Na Bashkoni Flamuri"	Na bashkoni flamuri, Trupa AP Shqiptarë, Ansambli Shota Kosove, AP Maqedonia e Veriut	TKOBAP		29.11.2024	Fondi rezervë i Buxheut të Shtetit	1,632,000	1,532,000



59	Realizimi i ceremonive në të gjitha vendin në përshkrim të bashkëpunimit nga shtetet e fqinjë të cilët kanë përvojat e ngjashme vitit 2024.	Organizimi i ceremonive në përshkrim të 38 burimeve që kanë humbur jetën në krye e për shkak të detyrës.Ceremonitë do të organizohen në të gjitha qarqet.	Policia e Shtetit	Prefektura	01.12.2024	Policia e Shtetit	960,000	
60	Libri i përshkrimit i gjuhës dhe kulturës në shqipëri në diasporë nivel II	Libri i përshkrimit për promovimin e gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë dhe nxirjen e atdhetashit tek shqiptarët jashtë atdheut.	Ministria e Arimit dhe Sportit	MAS; MASHT; QBD		QBD		
61	Suvenirat e 80 vjetorit	Pergatitja e një serie suvenirsh të cilat përshkruajnë shtet, për 80 vjetorin apo modele të tjera të posaçme, "bulgare" minijochte për familjet e pasardhëseve të deshmorëve të LANC në bashkëpunim me Shokaten e Veteranëve dhe DPA-së. Përgatitja e imazheve (foto e dokumente), Stanimi, digitalizimi i tyre,Prodhim i suvenirëve,Dispozimi i tyre	Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave,Ministria e Mbrojtjes,Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	01.06.2024	Ministria e Mbrojtjes	3,000,000	
62	Botimi i Librit 'Dashmori e Adhesh'	Botimi i Librit 'Dashmori e Adhesh' 10.000 copë	MM,ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE DHE DESHMORËT E TËRIË TË ATDHEUT	MM,ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE DHE DESHMORËT E TËRIË TË ATDHEUT	01.11.2024	Ministria e Mbrojtjes	500,000	
63	Musji i Filmit Shqiptar	Shfaqje filmore të kinematografisë shqiptare me tematikë "Jullian e Il Bokseri" dhe diskutimi mbi problematikat që trajtojnë, sipas kinematografisë së shfaqjes.	Përfshirje Diplomatike Ambasada në Athinë Komandanta në Skutari Ambasada në Ankara Ambasada në Sofje Ambasada në Pragë Ambasada në Zagreb Komandanta në Minsk Ambasada në Berlin Ambasada në Londër Ambasada në Vukovar Misioni në Gjenevë Ambasada në Bernë Ambasada në Abu Dhabi Ambasada në Beograd Ambasada në Prishtinë Ambasada në Podgoricë Ambasada në Tokio Ambasada në Bukuresht	AQSDHF	01.11.2024	Fondi rezervë i Dëshmorit të Shtetit	5,900,000	5,540,000
64	Ekspozitë e njohur me foto historike	Ekspozitë e njohur me foto historike, e cila do të shfaqet në përshkrimet me përmbajtjen e përgatitur nga DPA.	Përfshirje Diplomatike Ambasada në Athinë Komandanta në Skutari Ambasada në Ankara Ambasada në Sofje Ambasada në Pragë Ambasada në Zagreb Komandanta në Minsk Ambasada në Berlin Ambasada në Londër Ambasada në Vukovar Misioni në Gjenevë Ambasada në Bernë Ambasada në Abu Dhabi Ambasada në Beograd Ambasada në Prishtinë Ambasada në Podgoricë Ambasada në Tokio Ambasada në Bukuresht	DPA	01.11.2025	MPJ	6,300,000	
							51,250,000	23,220,000
Buxheti total								
Buxheti nga Fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit								23,220,000
Buxheti aktual i institucioneve								28,040,000

**VENDIM****Nr. 325, datë 29.5.2024****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR KONTRIBUTIN E SEKTORIT
PRIVAT NË KRIJIMIN E FONDIT
PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat për krijimin e fondit publik të banesave sociale, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar.

2. Në kontratën paraprake midis njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit privat, që paraqet kërkesën për leje zhvillimi dhe ndërtimi, përcaktohet mënyra e përfitimit të fondit publik të banesave sociale, referuar sipërfaqeve me metër katror apo e dhënë ajo në vlerë leku, sipas çmimit referues të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa” për zonën ku po ndërtohet, bazuar në sipërfaqen e përgjithshme funksionale të objektit të banimit në ndërtim. Kontrata paraprake lidhet në momentin e dhënies së lejes së ndërtimit/zhvillimit.

3. Përcaktimet e pikës 2, të këtij vendimi, zbatohen edhe në rastet kur një subjekt, që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit, sipas pikës 2, të nenit 19, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar.

4. Sipërfaqen takuese, referuar nenit 19, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, në përmbushje të qëllimit të strehimit, në rast pamundësie për ta dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, subjekti privat e jep atë menjëherë në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi, në përputhje me normat e projektimit të banesave, përfunduar dhe certifikuar me dokumentin e pronësisë, duke e ekuivalentuar në vlerë monetare, sipas çmimit referues të pasurisë paluajtshme “ndërtesa” për zonën ku po ndërtohet, për të cilin është dhënë leja ndërtimore.

5. Për të gjitha ato subjekte që janë pajisur me leje ndërtimi dhe nuk kanë nënshkruar ende kontratën përfundimtare të kalimit të pronësisë me njësinë e vetëqeverisjes vendore, subjekti mund të propozojë që sipërfaqen ndërtimore, në funksion të fondit publik të banesave sociale mund ta ofrojë për ta dhënë në një sipërfaqe të ndryshme nga ajo që po ndërtohet, por me kushtin që sipërfaqja të jetë e përfunduar dhe e certifikuar me dokumentet e pronësisë. Edhe në këtë rast, ekuivalentimi në vlerë monetare bëhet sipas çmimit referues të pasurive të paluajtshme “ndërtesa” për zonën ku po ndërtohet.

6. Kontrata përfundimtare, që nënshkruhet midis njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit privat për kalimin e sipërfaqes ndërtimore, në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kjo kontratë përmban të dhënat e sakta në lidhje me sipërfaqen, zonën, numrin e njësive të banimit dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

7. Në rast se kalimi i sipërfaqes ndërtimore është e dhënë në vlerë leku, fondi kalon nga investitori në llogarinë e posaçme të njësive të vetëqeverisjes vendore, në favor të fondit publik të banesave sociale.

8. Ngarkohen njësitet e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 327, datë 29.5.2024**

PËR AUTORIZIMIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË DHE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE ANTIKORRUPSIONIN TË NEGOCIOJNË DREJTPËRDREJT ME SUBJEKTIN NDËRKOMBËTAR *BOSTON CONSULTING GROUP (BCG)* PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË KONSULENCËS, PËR IDENTIFIKIMIN E MEKANIZMAVE EFICIENTË PËR TË NXITUR MË TEJ LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE MUNDËSINË E PËRDORIMIT TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE (IA) PËR KËTË QËLLIM

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, ‘Për prokurimin publik’”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin të negociojnë drejtpërdrejt me subjektin ndërkombëtar *BOSTON CONSULTING GROUP (BCG)* për ofrimin e shërbimit të konsulencës për identifikimin e mekanizmeve eficientë për të nxitur më tej luftën kundër korrupsionit dhe mundësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) për këtë qëllim.

2. Negocimi ka në objekt këto 3 (tri) fusha:

a) Analizë për identifikimin e mekanizmeve eficientë dhe dhënien e rekomandimeve për luftën kundër korrupsionit, duke u fokusuar në veçanti në rishikimin e funksioneve dhe organizimit institucional të institucioneve të administratës shtetërore, aspekteve së strukturës të sistemit ministror dhe proceseve vendimmarrëse, me qëllim rritjen e eficiencës dhe eliminimin e hapësirave korruptive;

b) Analizë dhe rekomandime, me qëllim parandalimin e korrupsionit në ofrimin e shërbi-

meve publike përmes rritjes së eficiencës dhe llogaridhënies;

c) Analizë dhe rekomandime për mundësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale në proceset vendimmarrëse dhe atë të ofrimit të shërbimeve, me qëllim eliminimin e hapësirave të mundshme korruptive.

3. Ngarkohen ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 328, datë 29.5.2024**

PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË PRONAVE SHTETËRORE, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DISA INSTITUCIONEVE SHTETËRORE, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË INVESTIMIT “PËR ZHVILLIMIN DHE MENAXHIMIN E PRONAVE SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në zbatim të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT: M01917011D, të pronave shtetërore sipas shtojcës



nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi, për realizimin e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore”.

2. Autorizimin e shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues i pronave me funksion vetëm publik, në emër dhe për llogari të pronarit shtet, për pronat shtetërore, sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Korporata e Investimeve Shqiptare, apo entiteti i krijuar prej saj, zhvillon pronat e përcaktuara në shtojcën nr. 1 dhe në shtojcën nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi, në funksion të realizimit të projekteve të investimit, të cilat kanë si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.

4. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare dhe institucionet e përcaktuara në shtojcën nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi, apo autoritetet e autorizuar prej tyre, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik, autoritetit në përgjegjësi administrimi të të cilit regjistrohet prona e re shtetërore, që zhvillohet si rezultat i përmbushjes së kushtit të transferimit të pronës/autorizimit për zhvillim, në të cilin përcaktohen edhe kushtet e nevojat për dorëzimin e pronës, si dhe sigurimin e ambienteve të përkohshme për vazhdimin e aktiviteteve të institucioneve publike që përdorin/administrojnë këto prona, në rastet kur institucionet për nevoja të zhvillimit të projektit të investimit janë të detyruara të lirojnë këto prona.

5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, apo subjekte të krijuara prej saj, për hapjen e procedurave konkurruese përzgjedhëse dhe negocimin me subjekte private apo publike për lidhjen e marrëveshjes/kontratës për zhvillimin e pronave të transferuara në pronësi apo për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projekteve të investimit, në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar.

6. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit, apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit, si dhe të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin, në emër të Republikës së Shqipërisë dhe në përgjegjësi administrimi apo përdorim, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit, të pronës së re shtetërore që do të krijohet në kuadër të projekteve të investimit.

7. Institucionet publike, të cilat zhvillojnë aktivitet në godinat e ngritura në pronat e përcaktuara në këtë vendim, do të vazhdojnë të përdorin pronën në funksion të aktivitetit të tyre deri në momentin e marrjes në dorëzim të ambienteve të reja, të ndërtuara, në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në marrëveshjet, sipas pikës 4 të këtij vendimi. Kur, për nevoja të realizimit të projektit të investimit, institucioni publik duhet të largohet nga prona ku kryen aktivitet, institucioni publik, me njoftimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare liron ambientet ku kryen veprimtarinë e tij, vetëm pasi Korporata e Investimeve Shqiptare, në bashkëpunim me institucione të tjera publike apo subjekte private, i ka garantuar vazhdimin e aktiviteteve të punës në ambiente të tjera deri në marrjen në dorëzim të ambienteve të reja të ndërtuara.

8. Në funksion të zhvillimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcën nr. 1 dhe në shtojcën nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi, vetëm pasi ka siguruar vazhdimin e aktiviteteve të institucioneve publike, që përdorin / administrojnë këto prona, në ambiente të tjera deri në marrjen në dorëzim të ambienteve të reja të ndërtuara.

9. Autorizohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të kryejë procedurat e prokurimit “Konkurs projektimi” për marrjen e projektideve të zhvillimit të pronave të listuara në shtojcën nr. 1 dhe në shtojcën nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi. Shpenzimet për këto shërbime mbulohen nga buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare.



10. Në listat e pronave, që i bashkëlidhen vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 18.7.2003, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, i ndryshuar, nr. 191, datë 15.3.2017, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal të godinave dhe truallit funksional të tyre, ndodhur në zonën kadastrale 8210, me numër pasurie 3/74, me sipërfaqe 5044.85 m², dhe me numër pasurie 3/183, me sipërfaqe 1580.89 m²”, të ndryshuar, nr. 80, datë 10.2.2010, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve, nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit së Pronave”, nr. 572, datë 3.8.2016, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministria e Drejtësisë, për Agjencinë e Trajtimin të Pronave, dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, të katit përdhes dhe të katit të tretë e të katërt të godinës së Institutit të Ndërtimit, Tiranë”, nr. 1085, datë 18.12.2023, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave tek Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, të pronës së paluajtshme shtetërore me nr. pasurie 7/124, ZK 8270, me vendndodhje në rrugën “Dora d’Istria”, Tiranë, për t’u përdorur nga ALUIZNI”, nr. 481, datë 31.7.2018, “Për kalimin në përgjegjësi

administrimi, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e saj të varësisë të Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për institucionet brenda fushës së veprimtarisë së saj të mjediseve, me vendndodhje në bulevardin “Zhanë d’Ark, nr. 23, Tiranë (ish-Agjencia Telegrafike Shqiptare)”, nr. 111, datë 6.3.2024, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, të pasurisë me nr. 7/120 dhe të një pjese të pasurisë me nr. 7/466, ZK 8270, Tiranë”, të hiqen pronat shtetërore, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Drejtësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

Nr.	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me përgjegjësi administrimi / pronësi
				Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
1	2947	441/30	117 410	117 410	641,2	Ministria e Mbrojtjes VKM nr. 515, datë 18.7.2003, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar
2	2947	386/3	47 585	47 585	-	Ministria e Mbrojtjes VKM nr. 515, datë 18.7.2003, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar
3	8210	3/413	1 204.6	1 204.6	-	Fondi Shqiptar i Zhvillimit VKM nr. 254, datë 29.4.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 191, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal të godinave dhe truallit funksional të tyre, ndodhur në zonën kadastrale 8210, me numër pasurie 3/74, me sipërfaqe 5044.85 m ² , dhe me numër pasurie 3/183, me sipërfaqe 1580.89 m ² ”
4	8210	3/71-N1	876	-	876	Ministria Drejtësisë VKM nr. 572, datë 3.8.2016, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministria e Drejtësisë, për Agjencinë e Trajtimin të Pronave, dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, të katit përdhes dhe të katit të tretë e të katërt të godinës së Institutit të Ndërtimit, Tiranë”



5	8210	3/71-N2	589	-	589	Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave VKM nr. 80, datë 10.2.2010, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve, nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave"
6	8210	3/71-N3	589	-	589	Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave VKM nr. 80, datë 10.2.2010, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve, nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave"
7	8210	3/71-N4	589	-	589	Ministria e Brendshme VKM nr. 572, datë 3.8.2016, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi tek Ministria e Drejtësisë, për Agjencinë e Trajtimin të Pronave, dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, të katit përmbes dhe të katit të tretë e të katërt të godinës së Institutit të Ndërtimit, Tiranë"
8	8210	3/71-N5	589	-	589	Ministria e Brendshme VKM nr. 572, datë 3.8.2016, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi tek Ministria e Drejtësisë, për Agjencinë e Trajtimin të Pronave, dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, të katit përmbes dhe të katit të tretë e të katërt të godinës së Institutit të Ndërtimit, Tiranë"
9	8210	3/71	862.17	862.17	862.17	Shtet
10	8210	3/72	290.78	290.78	-	Shtet
11	8270	7/124	2 019	2 019	806	Agjencia Shtetërore e Kadastrës VKM nr. 1085, datë 18.12.2013, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave te Ministria e Zbvillemit Urban dhe Turizmit, të pronës së paluajtshme shtetërore me nr. pasurie 7/124, ZK 8270, me vendndodhje në rrugën "Dora d'Istria", Tiranë, për t'u përdorur nga ALUIZNI"
12	8150	6/194	2 840	2 840	886	Ministria e Arsimit dhe Sportit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit VKM nr. 481, datë 31.7.2018, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e saj të varësisë te Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për institucionet brenda fushës së veprimtarisë së saj, të mjediseve, me vendndodhje në bulevardin "Zhanë d'Ark, nr. 23, Tiranë (ish-Agjencia Telegrafike Shqiptare)"
13	8270	7/929	1 023.7	1 023.7	660.3	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë VKM nr. 111, datë 6.3.2024, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, të pasurisë me nr. 7/120 dhe të një pjese të pasurisë me nr. 7/466, ZK 8270, Tiranë"
14	8270	7/929-N2	660.3	-	660.3	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë VKM nr. 111, datë 6.3.2024, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, të pasurisë me nr. 7/120 dhe të një pjese të pasurisë me nr. 7/466, ZK 8270, Tiranë"
15	8270	7/929-N3	670.42	-	670.42	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë VKM nr. 111, datë 6.3.2024, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, të pasurisë me nr. 7/120 dhe të një pjese të pasurisë me nr. 7/466, ZK 8270, Tiranë"
16	8270	7/929-N4	519.37	-	519.37	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë VKM nr. 111, datë 6.3.2024, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, të pasurisë me nr. 7/120 dhe të një pjese të pasurisë me nr. 7/466, ZK 8270, Tiranë"
17	8270	7/929-N5	519.37	-	519.37	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë VKM nr. 111, datë 6.3.2024, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, të pasurisë me nr. 7/120 dhe të një pjese të pasurisë me nr. 7/466, ZK 8270, Tiranë"



SHTOJCA NR. 2
PRONAT ME FUNKSION VETËM PUBLIK PËR TË CILAT KORPORATA VEPRON SI ZHVILLUES

Nr.	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me përgjegjësi administrimi/ pronësi
				Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
1	8330	8/114	7 500	7 500	2 500	Agjencia Shtetërore e Kadastrës VKM nr. 381, datë 13.5.2020, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të mjedisve të Arkivit Shtetëror Vendor të qarkut Tiranë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave", të ndryshuar. VKM nr. 31, datë 19.1.2022, "Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të një pjese të pasurisë nr. 8/114, zona kadastrale 8330, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve", të ndryshuar
2	8270	6/726	6 620	6 620	2 367.83	Këshilli i Ministrave VKM nr. 87, datë 21.2.2024, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", të ndryshuar
3	8270	6\9	48	-	-	Shtet
4	8270	6\95	2 412	2 412	1230	Kuvendi Republikës së Shqipërisë VKM nr. 324, datë 16.5.2012, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", të ndryshuar
5	8270	6/447	79	79	-	Shtet
6	8270	6/468	158	-	-	Shtet
7	8270	6/483	15	15	-	Shtet
8	8270	6/508	346	346	-	Shtet
9	8270	6/603	1571,5	1571,5	-	Shtet
10	8270	6/99-ND+1-N1	389	-	389	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë VKM nr. 346, datë 12.5.2010, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjedisve, nga Këshilli i Ministrave tek Autoriteti i Ariacionit Civil, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare" VKM nr. 716, datë 2.9.2010, "Për disa shtesa në vendimin nr. 346, datë 12.5.2010, të Këshillit të Ministrave, Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjedisve, nga Këshilli i Ministrave tek Autoriteti i Ariacionit Civil, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare"
11	8270	6/99-ND+1-N3	253.2	-	253.2	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë VKM nr. 346, datë 12.5.2010, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjedisve, nga Këshilli i Ministrave tek Autoriteti i Ariacionit Civil, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare" VKM nr. 716, datë 2.9.2010, "Për disa shtesa në vendimin nr. 346, datë 12.5.2010, të Këshillit të Ministrave Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjedisve, nga Këshilli i Ministrave tek Autoriteti i Ariacionit Civil, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare"

SHTOJCA NR. 3
INSTITUCIONET PUBLIKE TË CILAT LIDHIN MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT ME KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE

Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, apo institucione të autorizuar prej saj, Agjencia Kombëtare e Ujësjetellës-Kanalizimeve, Autoriteti i Aviacionit Civil, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, institucione në varësi të Kryeministrit sipas përcaktimit në marrëveshjet përkatëse.

**VENDIM****Nr. 15, datë 23.5.2024****BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 15, datë 23.5.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Berat, dosje nr. 442, dosje drejtimi për industrinë e naftës, me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

2. Arkiva e Autoritetit, fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale nr. 4332, “Stilografi” në ngarkim të T. I. B., me 30 (tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

3. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, fashikull pa nr. “Guxilla” në ngarkim të P. Gj. G., me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

4. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje formulare nr. 3202, në ngarkim të A. Q. M., me 46 (dyzet e gjashtë) fletë.

Dosja daton në vitet 1974–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

5. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje formulare nr. 215, në ngarkim të J. I., me 40 (dyzet) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje formulare nr. 105, në ngarkim të Th. P. N., me 313 (treqind e trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1965–1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje përpunimi nr. 4475, në ngarkim të K. R., me 2 volume me 307 (treqind e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1975–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

8. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Mat, dosje pune nr. 2344, “I Penduari”, me 345 (treqind e dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1976–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

9. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Gjirokastrë, Regjistër model. 2 nr. 1, me 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Regjistri daton në vitet 1958–1991. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “Sekret”.

10. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje përpunimi nr. 3109, në ngarkim të P. Xh., me 3 volume me 594 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

11. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Berat, dosje përpunimi nr. 2143, në ngarkim të A. R. Z., me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1980–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

12. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega IV, dosje formulare nr. 630, në ngarkim të K. Ll. Th., me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1947–1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

13. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje drejtimi naftës nr. 748, mbi agjenturën dhe veprimtarinë armiqësore e keqbërëse, me 2 volume me 264 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet



1984–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

14. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje formulare nr. 4364, dhe fashikull personal për të dënuar në ngarkim të E. R. L., me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1979–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

15. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje përpunimi nr. 3112, në ngarkim të Dh. Th. P., me 209 (dyqind e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1980–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

16. Arkiva e Autoritetit, fondi të Arratisur, dosje formulare nr. 431, në ngarkim të V. R., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1947–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

17. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, Regjistër model. 2 nr. 24, me 200 (dyqind) fletë. Regjistri daton në vitet 1955–1991. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “Sekret”.

18. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Elbasan, Regjistër model. 2 nr. 2, me 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë. Regjistri daton në vitet 1958–1991. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “Sekret”.

19. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje pune dhe personale nr. 6445, “Tomorri” në ngarkim të Th. P. Sh., me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

20. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje përpunimi nr. 3203, në ngarkim të V. K. B., me 222 (dyqind e njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1975–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

21. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje formulare nr. 2441, në ngarkim të P. Dh. B., me 24 (njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

22. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje përpunimi nr. 3546, në ngarkim të S. H., me 102 (njëqind e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1963–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

23. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje pune dhe personale nr.

5091, “Drita” në ngarkim të V. F. R., me 131 (njëqind e tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

24. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, dosje pune dhe personale nr. 1889, “Trim” në ngarkim të A. T. Sh., me 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

25. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, dosje personale nr. 5094, “Besniku” në ngarkim të S. V. K., me 50 (pesëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

26. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje përpunimi nr. 3144, në ngarkim të N. K., me 3 volume me 402 (katërqind e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1975–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

27. Arkiva e Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje përpunimi nr. 3498, në ngarkim të V. Ll. P., me 279 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1962–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

